



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në:
“E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile: “E Drejtë Private”; “E Drejtë
Biznesi”**

Universiteti Europian i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Mirela P. BOGDANI

Dr. Artan SPAHIU

Maj / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave” në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile: “E Drejtë Private”;
“E Drejtë Biznesi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Juridike
3	Emërtimi i programit të studimit:	“Master i Shkencave” në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile: “E Drejtë Private”; “E Drejtë Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.74, datë 21.01.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i MAS Nr. 380, datë 12.10.2015
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 22, datë 11.05.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit për vitin akademik 2021-2022	10 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	<u>Viti akademik 2021-2022</u>


		E Drejtë Biznesi 10 studentë E Drejtë Private 21 studentë <u>Viti akademik 2022-2023</u> E Drejtë Biznesi 6 studentë E Drejtë Private 20 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave” në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile: “E Drejtë Private”; “E Drejtë Biznesi”, ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, të Universitetit Europian të Tiranës. Ky program studimi është licencuar me VKM Nr.74, datë 21.01.2009. Me urdhër të MAS Nr. 68, datë 14.02.2011 është bërë akreditimi i parë i programit të studimit, ndërsa akreditimi periodik është miratuar me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 22, datë 11.05.2018, për 5 vite akademike. Me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 380, datë 12/10/2015, është bërë reregjistrimi i formës së diplomës, së programit të studimit në vlerësim, në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademik në përfundim të të cilit lëshohet diplomë, “Master i Shkencave” në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile: “E Drejtë Private”; “E Drejtë Biznesi”.

Ky program studimi synon të ofrojë tek studentët njohuri të thelluar teorike dhe praktike, për ti pajisur atë aftësi analitike për kuptuar dhe ofruar zgjidhje potenciale për problemet juridike në kontekstin e të drejtës private dhe të biznesit. Objekti i këtij masteri është krijimi i specialistëve me formim teorik të thelluar dhe me kapacitete për kërkim shkencor të matshëm, aftësi të përshtatshme për integrimin në tregun e punës në nivel kombëtar, rajonal por edhe më gjerë. Programi mbështetet nga një staf pedagogjik i specializuar në këtë fushë dhe me eksperiencë në fushën e mësimdhënies.





3


PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH”, si dhe në përputhje me Manualin “Për procedurën dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit” të ASCAL, UET ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit periodik të programit të studimit *MSC në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile “E Drejtë Private”, “E Drejtë Biznesi”,* nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL. Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standarteve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr.824, dt.24.12.2021 për programin e studimit të ciklit të dytë *MSC në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile “E Drejtë Private”, “E Drejtë Biznesi”.*

ASCAL bazuar në manualin “Për procedurën dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga IAL, për të kryer vizitën në institucion si dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) përbëhet nga: Prof.As.Dr. Mirela P. Bogdani dhe Dr. Artan Spahiu. Gjatë gjithë etapave të punës për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm ky grup u asistua nga ekspertja e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.



Vizita dy ditore në IAL u realizua në datat 26-27 Shtator 2023, ku GVJ realizoi të gjitha takimet e parashikuara, duke respektuar axhendën e vizitës në IAL. Gjatë ditëve të vizitës GVJ zhvilloi takime me: Dekanin e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Përgjegjës të Departamentit të Shkencave Juridike; Grupin e Vlerësimit të Brendshëm; stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi (*efektiv dhe me kontratë*); përfaqësues të Drejtorisë së Standardeve dhe Cilësisë; studentët e programit të studimi; përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore; Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve; Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Sekretarinë Mësimore. GVJ gjithashtu vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi nga afër mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës u shqyrtuan çështje të ndryshme, që lidhen me vlerësimin e programit të studimit *MSC në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile “E Drejtë Private”, “E Drejtë Biznesi”,* duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, në gjuhën shqipe dhe angleze: Krahas këtyre u shfrytëzuan edhe informacioni i depozituar në sistemin e menaxhimit të informacionit të ASCAL si dhe informacioni i vënë në dispozicion gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në IAL. Në përfundim të këtij procesi GVJ dorëzoi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm në ASCAL.



Universiteti European i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.04.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 40 / 12 Prot, datë 02.04.2024. Universiteti European i Tiranës njofton në ASCAL më datë 24.04.2024, me anë të shkresës me Nr.37/7 Prot, datë 23.04.2024 “Kthim përgjigje mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

- 1. Për Komentin që i përket Standardit I.3, kriteri 4 & konkluzione, GVJ merr në konsideratë sqarimin e bërë në lidhje me ekzistencën e një template “RAPORT PËR PËRFITIMET NGA MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT”. Nga grupi i vlerësimit të jashtëm vlerësohet se UET ka hartuar template/formularë për raportimin e bashkëpunimeve me institucione apo aktorë jashtë IAL-së. Në këto kushte, **raporti ndryshon** duke hequr konstatimin e bërë në RVJ, në Standartin I.3, Kriteri 4 dhe në Konkluzionet e këtij standarti.**
- 2. Për Komentin që i përket Standardit III.4, kriteri 4, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst duke pasur karakter nxitës që studentët të kenë mundësi reale për të zhvilluar njohuritë e marra në auditor në praktika profesionale. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.****
- 3. Për Komentin që i përket Standardit IV.1, kriteri 1, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst, që Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.****



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI PARAARDHËS:

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit, sipas Vendimit Nr.22, datë 11.05.2018 janë:


1. Institucioni të sigurojë që titullarët e lëndëve të jenë personel akademik efektiv, me grada dhe tituj;
2. Institucioni duhet të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo organizata të biznesit, në kuadër të zhvillimit të praktikës profesionale të studentëve si dhe kjo praktikë të koordinohet edhe me drejtuesin e temës së diplomës në mënyrë që të shërbejë edhe si një mjedis në të cilin studenti të grumbullojë eksperiencën e duhur për përgatitjen e saj;
3. Institucioni duhet të shtojë numrin e personelit akademik të angazhuar në funksion të mbikqyrjes së praktikave profesionale të studentëve;
4. Institucioni të sigurojë shpërndarjen e peshës së krediteve në dy vitet akademike në mënyrë të barabartë, përpara fillimit të vitit akademik të ri;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Për Rekomandimin e parë, Institucioni ka marrë masa që që titullarët e lëndëve të jenë personel akademik efektiv, me grada dhe tituj (*ref. dokumenti nr.38*). Departamenti ka bërë pjesë të stafit akademik pedagogë të cilët kanë eksperiencë të gjatë në fushën e së drejtës dhe në administratën publike, për vetë veçorinë e programit Master, ku kërkohet eksperiencë praktike dhe specializim nga ana e pedagogëve. Për 5 vitet akademike në vlerësim, të dhënat për gradat dhe titujt e pedagogëve, titullarë të lëndëve të këtij programi studimi, paraqiten si më poshtë:

- ✓ Në vitin akademik 2018-2019, nga 18 pedagogë të angazhuar: 1 mbajnë titullin Prof.Dr; 4 mbajnë titullin Prof. As. Dr; 11 mbajnë graden Dr/PhD, dhe 2 As/Lektorë me titullin Msc.
- ✓ Në vitin akademik 2019-2020, nga 13 pedagogë të angazhuar: 2 mbajnë titullin Prof.Dr; 2 mbajnë titullin Prof. As. Dr; 5 mbajnë graden Dr/PhD; 3 mbajnë gradën Magjistër, dhe 1 As/Lektorë me titullin Msc.
- ✓ Në vitin akademik 2020-2021, nga 12 pedagogë të angazhuar: 3 mbajnë titullin Prof.Dr; 1 mban titullin Prof. As. Dr; 6 mbajnë graden Dr/PhD; 1 mban gradën Magjistër dhe 1 As/Lektorë me titullin Msc.
- ✓ Në vitin akademik 2021-2022, nga 11 pedagogë të angazhuar: 1 mban titullin Prof.Dr; 3 mbajnë titullin Prof. As. Dr; 7 mbajnë graden Dr/PhD.
- ✓ Në vitin akademik 2022-2023, nga 12 pedagogë të angazhuar: 4 mbajnë titullin Prof. As. Dr; 6 mbajnë graden Dr/PhD; 1 mban gradën Magjistër dhe 1 As/Lektorë me titullin Msc.

Të dhënat për raportin midis Personelit Akademik Efektivë dhe Personelit Akademik me Kontratë (shkurt, raporti PAE/PAK), paraqiten si më poshtë:



- ✓ Në vitin akademik 2018-2019, kemi raportin PAE/PAK - 13/5 (72% janëPAE);
- ✓ Në vitin akademik 2019-2020, kemi raportin PAE/PAK - 7/6 (54% janëPAE);
- ✓ Në vitin akademik 2020-2021, kemi raportin PAE/PAK - 7/5 (58% janëPAE);
- ✓ Në vitin akademik 2021-2022, kemi raportin PAE/PAK - 7/4 (64% janëPAE);
- ✓ Në vitin akademik 2022-2023, kemi raportin PAE/PAK - 9/3 (75% janëPAE);

Ky rekomandim është përmbushur pjesërisht, pasi ende në këtë program studimi konstatohet angazhim në mësimdhënie të personelit akademik me titullin Msc.

Për Rekomandimin e dytë, Institucioni (UET) ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe dhe shoqëri të biznesit vendas ose të huaj, duke lidhur marrëveshje me këto subjekte. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve ka qënë realizimi i objektivave të programeve të studimeve, duke siguruar marrëdhënie bashkëpunimi për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës (Ref. dokumenti nr.35). Gjithsej rezultojnë 27 marrëveshje bashkëpunimi, të lidhura nga UET, sipas informacionit të konstatuar në sistemin e menaxhimit të informacionit të ASCAL (Ref. dokumenti nr.34.1-nr.34.27). Bazuar në këto marrëveshje, studentët zhvillojnë praktikën profesionale në institucionet, apo subjektet e mësipërme, me të cilët janë lidhur marrëveshjet. Departamenti merr masa për të bërë të mundur që kjo praktikë të koordinohet edhe me drejtuesin e temës së diplomës, në mënyrë që të shërbejë edhe si një mjedis në të cilin studenti të grumbullojë eksperiencën e duhur për përgatitjen e saj. **Ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Për Rekomandimin e tretë Sipas deklarimeve të studentëve, në shumicën e rasteve studentët i kanë vendosur vetë kontaktet për të zhvilluar praktikën profesionale, me institucionet ku kanë punuar dhe në disa raste janë orientuar nga pedagogët e praktikës profesionale, të Departamentit të Shkencave Juridike. Departamenti i Shkencave Juridike, në vitin akademik 2022-2023, ka angazhuar 6 pedagogë efektivë në funksion të mbikëqyrjes së praktikave profesionale të studentëve (Ref. dokumenti Nr. 54.10). **Ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Për Rekomandimin e katërt. Rekomandimi për shpërndarjen e peshës së krediteve në dy vitet akademike, në mënyrë të barabartë, është zbatuar nga IAL-ja. Referuar planit mësimor për programin e studimit Master i Shkencave "E drejtë private dhe biznesi" - Programi i rishikuar (Ref. dokumenti Nr.14.2), është ruajtur një ekuilibër në secilin vit akademik me 60 kredite ECTS. Studimet në ciklin të dytë "Master i Shkencave" në "E Drejtë Private dhe Biznesi", ofrohet me 120 kredite ECTS dhe kanë kohëzgjatje normale 2 vite akademike, të organizuar në 4 semestra. **Ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**



17


Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile “E Drejtë Private”, “E Drejtë Biznesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	IA Lofron këtë program studimi, i cili nuk bie ndesh me interesat kombëtare por ruan dhe konsolidon vlerat akademike dhe ato kulturore – ky program synon formimin e specialistëve në fushën e së drejtës private dhe asaj të biznesit në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor në fuqi që rregullon çështjet e biznesit. <i>Ref. Dokumenti 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit konstatohet se është dizenuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij për formimin e specialistëve dhe ekspertëve në fushat e drejtë private dhe e drejtë biznesi, si dhe në reflektim të Strategjisë së Kërkimit Shkencor UET 2015-2020 (dhe më pas 2021-2025) <i>Ref. Dokumenti 2. Statuti UET _struktura organizative aktuale;</i> <i>Ref. Dokumenti 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Statuti dhe plani strategjik i UET specifikojnë qartë drejtimit prioritar duke vënë theksin në faktin se UET promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit ekonomik dhe social përmes transferimit të teknologjive dhe informacionit, në përgjigje globalizimit tregut të punës dhe diversifikimit të madh të arsimit të lartë në Shqipëri. Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UET, në përputhje me fushat e drejtimit akademike të tij. <i>Ref. Dokumenti 2. Statuti UET _struktura organizative aktuale;</i> <i>Evidencë nr.5. Rregullore e UET;</i>
Kriteri 4. Programi i	Programi i studimit është hartuar dhe zhvillohet në reflektim të

<p>studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>strategjisë kombëtare të zhvillimit të ekonomisë dhe biznesit, ruajtjes së interesit kombëtar dhe prirjeve globale të zhvillimit, konkretisht bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (dhe Planin e saj të veprimit), në Strategjinë Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023 (për më shumë referohu tek <u>Qeveria Shqiptare Keshilli i Ministrave (kryeministria.al)</u>) – megjithatë ende nuk ka të dhëna në nivel kombëtar lidhur me prirjet globale të ekonomisë ose analiza lidhur me numrin e ekspertëve që mund të kërkohen në një fushë të caktuar dhe kjo vështirëson disi përlogaritjen e saktë të nevojave të tregut të punës apo kuotave të studimit.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 2. Statuti UET_ struktura organizative aktuale;</i> <i>Ref. Dokumenti 3. Plani strategjik 2015-2020;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se IAL ofron programin e studimit të Ciklit të Dytë 'Master i Shkencave' në 'E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, duke synuar në ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UET është ndër institucionet e para të arsimit të lartë privat të krijuara në Shqipëri, i akredituar më tej në programet e studimit që ofron, ndaj edhe për këtë program studimi ofron përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike të biznesit dhe të drejtës private. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 48 pedagogë, nga të cilët 34 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - 4 kanë titullin “Profesorë”; - 4 kanë titullin “Profesor i Asociuar”; - 11 kanë gradën Dr./PhD; - 15 Asistent Lektorë me Msc; <p>dhe 14 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 kanë titullin “Profesorë”; - 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”; - 7 kanë gradën Dr./PhD; - 14 Asistent Lektorë me Msc; <p>Ndërsa Departamenti i Shkencave Juridike si departamenti përgjegjës për këtë program studimi në këtë vit akademik ka gjithsej 20 pedagogë, nga të cilët 8 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 ka titullin “Profesor”; - 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”; - 5 kanë gradën Dr./PhD; - 1 Magjistër <p>dhe 12 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 ka titullin “Profesor”; - 6 kanë gradën Dr./PhD; - 5 Asistent Lektorë me Msc; <p><i>Ref. Dokumenti nr 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB MSHDRPB, tabelat 1, 2;</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve</p>	<p>Universiteti European i Tiranës është i organizuar në pesë Fakultete konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; 2. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale; 3. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit; 4. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës; 5. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike; <p>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve</p>


kombëtare e evropiane.	<p>Ndërkombëtare ku përfshihet edhe programi i studimit ka një eksperiencë mbi 16 vite. Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është nëpërputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, si dhe në përputhje të plotë me klasifikimin e programeve të studimit sipas udhëzimeve kombëtare e evropiane</p> <p><i>Ref. Dokumenti nr.5. Rregullore e UET, Neni. 4, fq.2.</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike strukture brenda Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.GVJ, bazuar në RVB dhe vizitën e realizuar në institucion vërejtë që njësia bazë ishte në njohje të përgjegjësive në lidhje me programin e studimit dhe e angazhuar seriozisht për vënien e tij në jetë.</p> <p>Nga sa më sipër, vërtetohetse fusha e përgjithshme dhe specifike e programit ‘Master i Shkencave’ në ‘E Drejtë Private dhe Biznesi’ me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë që është Departamenti i Shkencave Juridike.</p> <p><i>Ref. Dokumenti nr 7. Rregullore MSH E drejte private dhe biznesi - shqip.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	N/A
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Pranë Universitetit European të Tiranës, funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Nëpërmjet kësaj zyre krijohen mundësi konsultash, orientimesh dhe trajnimesh të ndryshme. Një ndihmë e rëndësishme vjen dhe nga Tutoriati qe gjithashtu mbështet studentët në nevojat e tyre per orientim gjatë studimeve universitare por gjithashtu dhe për mundësi punësimi. GVJ konstatoi nga eksplorimi i faqes së internetit apo rrjeteve sociale, që në vijimësi zhvillon trajnime dhe aktivitete formimi profesional (forume, debate) edhe pas diplomimit të studentëve per shumë çështje të drejtësisë në përgjithësi dhe ato që lidhen me fushën e biznesit dhe ate civile. Në vijim të kësaj, disa prej tyre janë punësuar me kohë të plotë në</p>

	<p>këto programe studimi duke vijuar aty edhe formimin profesional të vazhduar në trajnimet që UET ka organizuar. Rekomandohet që kjo traditë të konsolidohet dhe vazhdohet më tej edhe në të ardhmen.</p> <p><i>Ref. Dokumenti nr 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit të Ciklit të Dytë 'Master i Shkencave' në 'E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësive kryesore dhe asaj bazë.</i></p> <p><i>UET zhvillon trajnime dhe aktivitete formimi profesional (forume, debate) edhe pas diplomimit të studentëve për shumë çështje të drejtësisë në përgjithësi dhe ato që lidhen me fushën e biznesit dhe ate civile. Në vijim të kësaj, disa prej studentëve të diplomuar janë punësuar me kohë të plotë në këto programe studimi duke vijuar aty edhe formimin profesional të vazhduar në trajnimet që UET ka organizuar. Rekomandohet që kjo traditë të konsolidohet dhe vazhdohet më tej edhe në të ardhmen.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së	<p>UET në përgjithësi dhe në vecanti Fakulteti i Shkencave Juridike ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi efektive brenda institucionit për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe analizës periodike të punës së tyre – këto detyra përcaktohen në Rregulloren e UET dhe Dokumentin për funksionimin dhe organizimin e Dekanatit dhe Departamentit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që cdo Fakultet të kishte rregullore të dedikuara për mbarëvajtjen dhe mbështetjen e veprimtarisë, konform ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në</i></p>

<p>përgjegjësi përkatese dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p><i>institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku të parashikohen, në mënyrë të detajuar, të gjitha modalitetet e drejtimit, koordinimit, detyrat/rolet përgjegjësitë për secilin autoritet.</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti nr.5. Rregullore e UET;</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UET në përgjithësi ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me aktorë të ndryshëm në fushën e institucioneve të administratës shtetërore, biznese private, media, etj.</p> <p><u><i>Ajo që do të rekomandonim</i></u> për programin e studimit ‘Master i Shkencave’ në ‘E Drejtë Private dhe Biznesi’ me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi është që vetë Fakulteti të ketë mundësi të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me institucione veprimtaria e të cilave lidhet drejtpërdrejt me profilin e fushës së studimit në biznes osë e drejtë private.</p> <p>Gjithashtu përpjekje mund të bëhen për të krijuar ura komunikimi me qendrat prestigjioze të së drejtës private në Evropë apo të biznesit si Max Planck Institute in Private Laë për të organizuar leksione osë forume të përbashkëta diskutimi.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 32. Lista e subjekteve dhe institucionet bashkëpunuese per programin e studimit dhe praktikat profesionale;</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatese për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe</p>	<p>Edhe ky kriter plotësohet mjaft mirë nga IAL, por Fakulteti mund të ketë pak më tepër fleksibilitet në këtë drejtim për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Lidhur me praktikat ato realizohen në institucione të ndryshme me të cilat UET ka marrëveshje zyrtare, me institucione të tjera që fillohet rishtas bashkëpunimi ose i lihet vetë në dorë studentit të zgjedhë vendin e praktikës sipas dëshirës së tij.</p> <p>Lidhur me mobilitetet, ende nuk ka të tilla për shkak të projekteve për kërkim shkencor ose marrëveshjeve me institucione të kërkimore, ndaj do të rekomandonim që në të ardhmen ky program të ofronte më shumë mundësi për kërkimin shkencor dhe shkëmbimet akademike (mobilitetet).</p> <p><i>Ref. Dokumenti 34 Marrëveshje bashkëpunimi -lista UET;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 32. Lista e subjekteve dhe institucioneve</i></p>

mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	<i>bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale;</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	GVJ konstatoi se raportet vjetore realizohen kryesisht nga UET dhe Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare kryesisht për praktikën mësimore, por për kërkimin shkencor, mobilitetin apo për aktivitete të tjera që rrisin profesionalizmin e studentëve të programit përgjithësisht nuk ka të dhëna, ndaj në të ardhmen <i>Ref. Dokumenti 34 Marrëveshje bashkëpunimi -lista UET;</i>			
Konkluzione	<i>UET siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit, por ajo që sugjerohet është qëvetë Fakulteti i Shkencave Juridike Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të ketë mundësi të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me institucione veprimtaria e të cilave lidhet drejtpërdrejt me profilin e fushës së studimit në biznës osë e drejtë private. Gjithashtu përpjekje mund të bëhen për të krijuar ura komunikimi me qendrat prestigjioze të së drejtës private në Evropë apo të biznesit si Max Planck Institute in Private Law për të organizuar leksione ose forume të përbashkëta diskutimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, dhe veprimtaritë tjera formuese përgjatë tij, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe rezultojnë të vlerësuara në kredite me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit në Master i Shkencave në ‘E Drejtë Private dhe Biznesi’ me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi realizohet në 2 (dy) vite akademike me 120 kredite ECTS. GVJ konstaton se lëndët në këtë program studimi janë të kategorizuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (kategorizimi A-E). GVJ konstaton se programi i studimit përmban informacion të plotë dhe të qartë mbi elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A: Lëndë bazë- 12 ECTS; - Kategoria B: Lëndë karakterizuese – 60 ECTS; - Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – 18 ECTS; - Kategoria D: Lëndë plotësuese – 12 ECTS; - Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës 18 ECTS; <p><i>Ref. Dokumenti 14. Kurrikula e programit MSH-E drejte private dhe biznesi;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në</p>	<p>Referuar planit mësimor programi i studimit Master i Shkencave në ‘E Drejtë Private dhe Biznesi’ me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi synon formimin e shprehive të veçanta në fushën e së drejtës së biznesit dhe së drejtës private në nivel teorik por edhe praktik në zgjidhjen e rasteve potencialisht përpara institucioneve administrative dhe atyre gjyqësore, në mënyrë që studentët të aftësohen edhe në praktikë për ndjekjen e këtyre problematikave dhe zgjidhjen e tyre, këtë synim ka edhe praktika e zhvilluar në institucione të ndryshme për ti aftësuar studentët për përshtatjen me tregun e punës.</p> <p>Nga ana tjetër, anazhimi si personel akademik me kohë të plotë</p>




<p>një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>apo të pjeshme i personaliteteve në sistemin e drejtësisë (p.sh. ish gjyqtarë të Gjykatës së Lartë apo të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm dhe drejtues apo funksionarë në disa institucioneve të larta të administratës shtetërore) u krijojnë mundësi studentëve të fitojnë eksperiencën e tyre të drejtpërdrejtë në fushat përkatëse si dhe të zgjidhin raste praktike të njëjta apo të ngjashme me ato që këta pedagogë ju paraqesin si kazuse gjatë lëksioneve, seminareve, apo edhe diskutimeve në forumet studentore. Gjithashtu vlen për t'u theksuar se nga angazhimi i këtyre personaliteteve, studentët kanë mundësi të krijojnë me ta kontakte personale dhe nëpërmjet tyre edhe me profesionistë të tjerë të fushës së biznesit, institucioneve gjyqësore, studiove të avokatisë, etj.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 14. Kurrikula e programit MSH-E drejte private dhe biznesi;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuara në mënyrë të detajuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Studenti duhet të marrë 120 kredite ECTS në përfundim të ciklit të studimit. Sipas Rregullores, 1 kredit është i barabartë me 25 orë mësimore pune të studentit, përbërë kjo nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, raste praktike/kazuse, projekt/detyra kursi, dhe veprimtari të tjera formuese), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.</p> <p>Pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi është dhe praktika profesionale/internship, e cila zhvillohet në vitin e dytë, semestri i dytë dhe ka 12 kredite ECTS (10% të ECTS total të programit të studimit). Sa i takon detyrimeve përmbyllëse, punimit të diplomës, studentët kanë të përcaktuar ngarkesën në 18 kredite ECTS. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome, i cili vlerësohet me notë.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 14. Kurrikula e programit MSH-E drejte private dhe biznesi;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i</p>	<p>N/A</p>




<p>ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UET është institucion jo-publik i Arsimit të Lartë, i cili organizohet dhe funksionin sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk gëzon statusin e IAL të veçantë.</p> <p>Lidhur me financimin e programit, u informuam se ai bazohet kryesisht nga të ardhurat e tarifave të studimit, sipas politikave të IAL – pasqyrat financiare të aktivitetit të programit të studimit paraqiten të plotë për vitet akademike 2018, 2019, 2020 (të uploduar në sistemin E-Ascal), nga ku konstatojmë se programi ka qëndrueshmëri financiare.</p>




<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit në Master i Shkencave në 'E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi, është i ngjashëm me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi të ofruara nga universitetet publike dhe private në vend. Kjo përshtatje mundëson transferimin e studimeve të studentëvebrenda vendit, por dhe jashtë vendit meqenëse lëndët janë të organizuara në bazë Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p><i>Ref. Dokumenti 14.2. Plani mesimor i programit- MSH- e Drejtë Private dhe Biznesi;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 14. Kurrikula e programit MSH-E drejte private dhe biznesi;</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas Nenit 86 "Kodifikimi i programeve të studimit", të Ligjit 80/2015, UET, në kuadrin e programit të studimit 'Master i Shkencave' në 'E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi ka kryer procesin e kodifikimit të programeve (bazuar në ISCED-F 2013) që përcakton <i>kurrikulën dhe rezultatet e të nxëniet të tij, fusha e programit të studimit sipas ISCED-F 2013: Juridik.</i></p> <p>Në këtë kuadër, pritet të shpallen nga Ministria përgjegjëse për arsimin, të gjitha kodet e programeve për të gjitha IAL.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 31.1. VKM Nr.310, datë 11.05.2022_Kodifikimi programeve;</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ndonëse UET ka parashikuar në Planin Strategjik të Zhvillimit ofrimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione vendase dhe veçanërisht të huaja, DSHJ nuk ofron programe të përbashkëta studimi.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 3. Plani strategjik 2015-2020;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit Master i Shkencave' në 'E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi dhe veprimtaritë e tjera formuese përgjatë tij, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe rezultojnë të vlerësuara në kredite me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi synon formimin e</i></p>




	<p><i>shprehive të veçanta në fushën e së drejtës së biznesit dhe së drejtës private në nivel teorik por edhe praktik në zgjidhjen e rasteve potencialisht përpara institucioneve administrative dhe atyre gjyqësore, në mënyrë që studentët të aftësohen edhe në praktikë për ndjekjen e këtyre problematikave dhe zgjidhjen e tyre.</i></p> <p><i>Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Drejtuesi i Departamentit, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës në një sërë institucionesh me të cilat UET ka lidhur marrëveshje; ajo është e detyrueshme dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave’ në ‘E Drejtë Private dhe Biznesi’ me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike (njësia bazë) në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Bazuar Vendimit BA Nr. 82, datë 22.09.2023, UET është akredituar në nivel Institucional për 4 (katër) vite akademike (22/09/2023 deri në 21/09/2027), duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni.</p> <p>Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është organizuar në 3 njësi bazë si më poshtë plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Juridike; 2. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara; 3. Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor; <p>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve</p>

Ndërkombëtare për vitin akademik 2022-20223 ka gjithsej 48 pedagogë, nga të cilët **34 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku:**

- 4 kanë titullin “Profesorë”;
- 4 kanë titullin “Profesor i Asociuar”;
- 11 kanë gradën Dr./PhD;
- 15 Asistent Lektorë me Msc;

dhe 14 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku:

- 2 kanë titullin “Profesorë”;
- 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”;
- 7 kanë gradën Dr./PhD;
- 14 Asistent Lektorë me Msc;

Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Juridike, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë

Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	2	1	2	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	3	3	2	-	1	-	2	1	1	-
Dr./PhD.	7	7	5	4	7	3	6	4	6	7
Msc.	6	3	2	3	1	4	-	-	-	4
Totali	17	14	11	8	11	8	9	6	8	12

Ref. Dokumenti 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB MSHDRPB;


Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik

Gjatë vizitës në IAL, GVJ u informua se në të gjitha ciklet e dyta të studimeve UET (Master), studenti krahas seancave në auditor kryen praktikë në një institucion organizatë kompani i mbikqyrur nga pedagogu përgjegjës idepartamentit, i caktuar në rolin e Këshilluesit të karrierës pra ka një person të dedikuar personel akademik përgjegjës për mbarëvajtjen e cdo elementi të praktikës mësimore. Gjithashtu për këtë qëllim, është caktuar

/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	edhe një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit.			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ konstaston se në bazë të vendimit Nr. 66, date 05.10.2021 të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike e Marrëdhënie Ndërkombëtare, është caktuar si koordinatorë program PhD.R. K. e cila është përgjegjëse për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. <i>Ref. Dokumenti 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Njësia kryesore ka caktuar koordinatorin e programit se edhe stuktura ndihmës akademike/administrative angazhohen në procesin e realizimit të praktikave mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Shkencave Juridike, si njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, ka të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të cilat jo vetëm janë publike në faqen e internetit por u bëhen të njohura studentëve që në momentin e aplikimit dhe më tej përgjatë cdo kursi/lënde.

<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimeve në Master i Shkencave në E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi", është bazuar në aktet e brendshme bazë të institucionit si dhe në aktet e brendshme, të cilat janë në funksion të këtij programi studimi. Kurrikula e programit të studimit është e organizuar në bazë të krediteve ECTS dhe orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit (orët individuale) për cdo lëndë. Lëndët në këtë program studimi janë lëndë që zhvillohen vetëm në një semestër akademik. Programi i studimit përmban informacionin e duhur akademik/mësimor, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 14.2. Plani mesimor i programit- MSH- e Drejte Private dhe Biznesi;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 14. Kurrikula e programit MSH-E drejte private dhe biznesi;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese MSH E DREJTË PRIVATE BIZNESI (Aneks_Tabela 9);</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se rregullorja e Programit të studimit në Master i Shkencave në E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi", ka të përcaktuar qartë dhe në mënyrë eksplicite të gjitha informacionet e nevojshme për studentët duke filluar nga kriteret specifike të pranimit, strukturën e programit të studimit, objektivat e programit të studimit sipas të gjitha profileve, kreditet, systemin e vlerësimit, transferimin dhe ekuivalentimin e lëndëve. Informacioni është në dispozicion të studentëve që në momentin e regjistrimit të tyre dhe ofrohet në vijimësi nga struktura akademike dhe administrative e institucionit.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë</p>	<p>Të gjitha këto informacione, sic u përmend më sipër u vihen studentëve në dispozicion përgjatë të gjithë ciklit të studimeve. Programet mësimore përditësohen cdo vit nga pedagogët e secilës lëndë ose grupi i pedagogëve të lëndës dhe përshatën me ndryshimet ligjore të fushës, rastet praktike të gjykatave si dhe nevojat/interesat e studentëve. Programi i studimit ofron informacionin e plotë mbi lëndët, orët akademike dhe formën e shpërndarjes së tyre në formën e leksioneve dhe seminarëve si dhe orët e punës individuale nga ana e studentëve, numrin e</p>

auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	krediteve ECTS, vitin/semestrin akademik ku zhvillohet. <i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i> <i>Ref. Dokumenti 14.2. Plani mesimor i programit- MSH- e Drejte Private dhe Biznesi;</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Departamenti i Shkencave Juridike si njësi bazë për këtë program studimi, diskuton në mbledhjet e kësaj njësie përmirësimin e programeve të lëndëve, në lidhje me literaturën që do të përdoret dhe temave që lidhen me aktualitetin. Çdo vit kërkohet përmirësim i syllabuseve, të cilat duhet të miratohen nga Grupet Mësimore Kërkimore. <i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, ka të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të cilat jo vetëm janë publike në faqen e internetit por u bëhen të njohura studentëve që në momentin e aplikimit dhe më tej përgjatë cdo kursi/lënde. Të gjitha informacionet lidhur me lëndët, semestrat, organizimin e programit, syllabuset, praktikën mësimore, syllabuset, ekuivalentimet, kreditet etj, u vihen studentëve në dispozicion përgjatë të gjithë ciklit të studimeve. Programet mësimore përditësohen cdo vit nga pedagogët e secilës lëndë ose grupi i pedagogëve të lëndës dhe përshaten me ndryshimet ligjore të fushës, rastet praktike të gjykatave si dhe nevojat/interesat e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit në Master i Shkencave në E Drejtë Private dhe Biznesi me profile, është në përputhje me fushën e studimit që ofron programi. Ky program përmes lëndëve që ofron, literaturës përkatëse mundëson që studentët të kenë mundësi të thellojnë njohuritë e tyre. Aktivitetet dhe veprimtaritë që përfshihen në programin e studimeve ndihmojnë në zhvillimin e aftësive, përmes një kombinimi të mësimit teorik dhe praktik, duke i përgatitur ata për sfidat e studimeve të mëtejshme ose për t'i bërë ata konkurrues në tregun e punës. Përmbajtja e kurrikulës së këtij programi studimi mundëson njohuri bazë dhe të thelluara, dhe është në përputhje me qëllimin dhe objektivat e këtij programi, të cilat janë të parashikuara dhe në rregulloren e tij.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Plani mësimor ka të përcaktuar qartë organizimin kohor të programit, duke specifikuar se si lëndët janë të shpërndara gjatë viteve dhe semestrave. Shpërndarja kohore ndihmon në përgatitjen graduale të studentëve për njohuritë dhe aftësitë që do të zhvillojnë, duke e shpërndarë ngarkesën në gjithë ciklin. Organizimi i veprimtarisë mësimore shtrihet në 4 (katër) semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Të gjitha lëndët e këtij programi studimi kanë të përcaktuar numrin e krediteve, shpërndarjen e orëve mësimore, formën e orëve mësimore (leksione/seminare), objektivat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, format e kontrollit të njohurive, komponentët e vlerësimit dhe shpërndarjen e tyre përgjatë zhvillimit të lëndës.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 14.2. Plani mesimor i programit- MSH- e Drejte Private dhe Biznesi;</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master</p>	<p>Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë janë në përputhje me profilin e programit; për këtë nuk ka të dhëna nga vetë IAL nëse ky program ka ngjashmëri me programe ndërkombëtare, por fakti që bazohet në lëndë që lidhen kryesisht me të drejtën private dhe atë të biznesit e bën shumë të ngjashëm me një sërë modulesh trajnimi profesionale që zhvillohen nga entet e biznesit, nga ana tjetër njohuritë e ofruara në këtë program studimi janë thuajse të njëjta me lëndë që zhvillohen në Shkollën e Magjistraturës, Shkollën e Avokatisë, etj, duke e bërë edhe më</p>




<p>Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>praktike, duke siguruar aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. Një element tjetër lidhet me faktin se disa pedagogë të përfshirë në programin e studimit, kanë qenë dhe disa prej tyre janë ende trajnerë në Shkollën e Magjistraturës në formimin fillestar dhe atë vazhdues, në Shkollën e Avokatisë gjë që krijon një harmonizim të njohurive profesionale teorike dhe praktike në fushën e së drejtës civile dhe të asaj të biznesit.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 14.2. Plani mesimor i programit- MSH- e Drejte Private dhe Biznesi;</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi reflekton një ndarje të drejtë të veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik, si në arritjen e objektivave të programit, edhe për transferimin e studimeve dhe eventualisht edhe punësim në përfundim të tyre. <i>Lidhur me Mobilitetet ende nuk ka pasur të tilla në programin e studimit por programi i studimit potencialisht ofron mundësi lëvizjeje.</i></p> <p>Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm; lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij; lëndë ndërdisiplinore (integruese) në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme apo integruese me disiplinat karakterizuese; lëndë plotësuese, të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të nënshkruara; detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar; <p><i>Ref. Dokumenti 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese MSH E DREJTË PRIVATE BIZNESI (Aneks_Tabela 9);</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve</p>	<p>Nga vizita në IAL, takimi me personelin akademik dhe strukturat drejtuese, si dhe konsultimi i dokumentacionit të depozituar për</p>




<p>/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>akreditimin, u informuam se programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, konsultohen nga Përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit.</p> <p>Cdo vit diskutohet përmirësimi i programit për tu përshtatur me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e fundit në fushën e drejtë private dhe biznesi. Literatura përbëhet nga literatura bazë e detyrueshme dhe literature ndihmësetë 5 viteve të fundit. Vlen të përmendet se në UET behet një përzgjedhje specifike e literatures qoftë e asaj bazë qoftë e literatures ndihmëse një pjesë e madhe e teksteve mësimore janë përkthyer nga autorët dhe botimet më të mira të universiteteve të njohura dhe rankuara ndërkombëtarisht, një vlerë e cmuar kjo në arsimin e lartë shqiptar.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 19. Silabus;</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Sic u theksua edhe më sipër, programi i studimit ofron dhënien e dijeve, aftësive dhe kompetencave bashkëkohore edhe sipas trajtimeve dhe koncepteve bashkëkohore evropiane (kjo për shkak të botimeve të teksteve të përkthyer) dhe për shkak të angazhimit të personelit akademik me eskepriencë jo vetëm në mësimdhënie por edhe në fusha praktike të së drejtës civile dhe asaj të biznesit, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Referuar RVB, programi i studimit është organizuar në mënyrë të tillë që student të marrë formimin e duhur teorik e praktik. Programi synon të formojë specialist në fushën e së drejtës private dhe e drejtë biznesi, duke i vënë një theks të vecantë kompetencave dh njohurive që lidhen me këto drejtime.</p> <p><i>RVB_MSH E Drejte Private dhe Biznesi _akreditim periodic;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit ofron dhënien e dijeve, aftësive dhe kompetencave bashkëkohore edhe sipas trajtimeve dhe koncepteve bashkëkohore evropiane (kjo për shkak të botimeve të teksteve të përkthyer - një vlerë e cmuar kjo në arsimin e lartëshqiptar) dhe për shkak të angazhimit të personelit akademik me eskepriencë jo vetëm në mësimdhënie por edhe në fusha praktike të së drejtës civile dhe asaj të biznesit, në përshtatje me</i></p>




	<p><i>kërkesat e tregut të punës. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikaës mësimore, u mundëson studentëve thellim të njohurive dhe aftësi të nevojshme për punësimin e tyre. Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, konsultohen nga Përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit. Programet e lëndëve/moduleve bazohen në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Nga takimi u informuam se në nivel Departamenti është ngritur një strukturë Bordi i tregut të punës për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik në këtë kontekst institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës si dhe opinionin e studentëve për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 2 Statuti UET, neni 30 pika 30.4;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të</p>	<p>Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, KSBC, gjithashtu studentët më të dalluar të departamenteve apo fakulteteve përkatëse përfshihen në kërkimin shkencor, botimet akademike, revistat shkencore, konferencat dhe ëorkshopet, aktivitetete të tjera kërkimore-shkencore, etj. Gjithashtu, u informuam edhe se Bordi i Tregut të Punës krijohet dhe ka në përbërje të tij ish studentë të UET, të cilët kanë zhvilluar një karrierë të spikatur profesionale pranë institucioneve ku janë</p>

përmirësimin të programit të studimit.	punësuar. <i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Sa më sipër, Departamentet në përgjithësi por edhe ato të programit të studimit që kërkohet të akreditohet, bazuar nga informacioni që marrin nga Bordi i tregut të punës, nga studentët por edhe nga aktivitetet kërkimore shkencore në fusha të ndryshme, në forume diskutimi me personalitete të fushës, ndikon në përditësimin dhe përshtatjen e programit e studimit.			
Konkluzione	<i>Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës si dhe opinionin e studentëve për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës. Në nivel Departamenti është ngritur Bordi i tregut të punës për të reflektuar në kurrikula zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat	Programi i studimit përcakton në mënyrë shumë të qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit në fushën e së drejtës civile dhe atë të biznesit si nga ana teorike edhe ajo praktike. Në të njëjtën linjë është edhe kërkimi shkencor, në përputhje këto me objektivat e institucionit kjo konstatohet nga programet e lëndëve të ndryshme si dhe nga aktivitetet kërkimore

madhorë të institucionit.	dhe profesionale që UET organizon periodikisht. <i>Ref. Dokumenti 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga takimi me personelin akademik që është angazhuar në programin Master i Shkencave në 'E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi u informuam se ata kanë pasur gjatë gjithë kohës një liri akademike të plotë në përzgjedhjen e literaturës, të rasteve praktike, të informacionit që diskutojnë dhe ndajnë me studentët në leksione dhe/apo seminare, në koordinim me njësinë kryesore. Gjithashtu edhe aktivitetet e organizuara në kuadrin e zgjerimit dhe/ose thellimit të njohurive në të drejtën civile, tregtare dhe atë të biznesit gjejnë mbështetje dhe koordinim të plotë nga Departamenti dhe UET. Ajo që vlen të përmendet është se të gjitha këto aktivitete gjejnë pasqyrim edhe në median sociale, dhe shpesh kanë një mbulim mediatik nga mediat kryesore. <i>Vizita ne institucion;</i> <i>Ref. Dokumenti 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Në vijim, në të gjitha këto aktivitete të Departamentit dhe UET në përgjithësi kryefjala janë studentët dhe interesat e tyre profesionale, zhvillimi i karrierës pas ciklit të studimeve, mundësitë për të krijuar kontakte të reja të dobishme me profesionistë të fushës, njohja me mundësitë për rritje të mëtejshme profesionale dhe akademike, etj. Këtë gjë e konfirmuan maksimalisht edhe studentët në takimin e zhvilluar, të cilët jo vetëm që kanë qënë të angazhuar nga stafi pedagogjik në forume diskutimi por kanë organizuar edhe vetë aktivitete të interesit të tyre profesional, të facilituar nga UET si nga ana e burimeve njërëzore edhe nga ajo financiare. <i>Vizita ne institucion;</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Referuar RVB stafi akademik është inkurajuar të hulumtojë e publikojë dhe në bazë të performancës të marrin grantet e tyre kërkimore. Departamenti mbështetet financiarisht nga institucioni i cili ofron fonde për aktivitete kërkimore e shkencore. <i>RVB_MSH E Drejtë Private dhe Biznesi akreditim periodic;</i>
Konkluzione	<i>Programi përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit në fushën e së drejtës civile dhe atë të biznesit si nga ana</i>

	<p>teorike edhe ajo praktike. Në të njëjtën linjë është edhe edhe kërkimi shkencor, në përputhje këto me objektivat e institucionit. Personeli akademik gëzon liri akademike të plotë në përzgjedhjen e literaturës, të rasteve praktike, të informacionit që diskutojnë dhe ndajnë me studentët në leksione dhe/apo seminare, në koordinim me njësinë kryesore. Aktivitetet e organizuara në kuadrin e zgjerimit dhe/ose thellimit të njohurive në të drejtën civile, tregtare dhe atë të biznesit gjejnë mbështetje dhe koordinim të plotë nga Departamenti dhe UET kryesjalla e tyre janë studentët dhe interesat e tyre profesionale, zhvillimi i karrierës pas ciklit të studimeve, mundësitë për të krijuar kontakte të reja të dobishme me profesionistë të fushës, njohja me mundësitë për rritje të mëtejshme profesionale dhe akademike, etj.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Departamenti u informuam se bën përpjekje të vazhdueshme për të mbështetur të gjitha projektet kërkimore-shkencore që lidhen me fushën e së drejtës në përgjithësi dhe në fushën civile dhe atë të biznesit në vecanti. Aktualisht sic edhe u informuam, përpjekja kryesore është e lidhur me angazhimin e personelit akademik në publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare apo edhe pjesëmarrje në konferenca shkencore. Kjo gjë realizohet edhe me angazhimin e studentëve në forume diskutimesh akademike ku së bashku me pedagogët e tyre parashtrajnë qasjet e ndryshme lidhur me fenomene shkencore, duke përfshirë edhe raste apo qasje praktike. Në të njëjtën linjë realizohet edhe bashkëpunimi nëse do të jetë e nevojshme me struktura të tjera, përfshirë edhe institucione të administratës shtetërore, entitete, apo organizata të tjera të cilat angazhohen në fushën me interes studimi. Departamenti mbështetjen e realizon nëpërmjet orientimit në përzgjedhjen e literaturës në fushën kërkimore,</p>

	<p>vendosjen e kontakteve me institucione të tjera, gjetjen e ekspertëve më të mirë të fushës dhe përfshirjen e tyre (koordinimin e procesit të angazhimit të tyre) në projekt, dhe herë pas here edhe gjetjen e fondeve në mbështetje të projektit kërkimor. Projektet kërkimore pranë departamentit zhvillohen edhe në trajtën e tezave të doktoraturave të cilat miratohen dhe ndiqen në nivel UET. Të gjitha këto procese reflektohen edhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2017-2020 dhe më tej 2020-2025 kur parashikohen proceset kërkimore doktorale, revistat e UET - <i>Polis, Economicus, Medicus</i> si dhe publikime në revista të tjera, etj.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025;</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti angazhohet vazhdimisht edhe në kryerjen e analizave kryesisht me natyrë ligjore, krahasuese por edhe të atyre statistikore në projekte, kryesisht nëpërmjet pedagogëve të tij me kohë të plotë por edhe atyre me kohë të pjesshme.</p> <p>Njësia bazë Departamenti i Shkencave Juridike angazhon studentët në pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore, duke organizuar konferenca si Konferenca e Ditëve të Studimeve Shqiptare (DSSH).</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Fakulteti periodikisht organizon aktivitete kërkimore-shkencore – kryesisht leksione të hapura ose forume diskutimi, në ndihmë të studentëve për të paraqitur punën e tyre kërkimore, ide, komente, qasje, analiza, etj; në të njëjtën linjë konstatohet edhe angazhimi i personelit akademik për të marrë pjesë në këto aktivitete ose individualisht apo në grupe mes tyre ose edhe në bashkëpunime me studentët kryesisht doktorantë;</p> <p><i>Ref. Dokumenti 10.1. Kalendari akademik 2018-2019;</i> <i>Ref. Dokumenti 10.5. Kalendari akademik 2022-2023;</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Referuar RVB, departamenti zhvillon programin e studimit në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore që rregullojnë profesionet që lidhen me fushën e së drejtës civile dhe private apo të biznesit konkretisht me avokatinë, noterinë dhe përmbartimin; në këtë kontekst studentëve ju jepet mundësia të ndjekin studime më të thelluara më pas për marrjen e licencës përkatëse. Gjithashtu ky program mundëson edhe formimin e studentëve në nivel Master përpara se ata të konkurojnë në Shkollën e</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e</p>	




<p>nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Magjistraturës. <i>RVB_MSH E Drejtë Private dhe Biznesi_akreditim periodic;</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Kurrikula e studimit, përmban edhe lëndë me spektër ndërkombëtar si: E Drejtë Ndërkombëtare Private; E drejtë Civile e Krahasuar; Zgjidhje Alternative e Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare; E Drejtë Financiare; Ekonomi Politike Ndërkombëtare; me qëllim që studentët të formohen rreth çështjeve me elementë ndërkombëtarë si nga ana teorike edhe ajo praktike, në reflektim edhe të programeve mëimore të universiteteve të huaja dhe të rregulloreve apo direktivave në nivel BE për formimin/aftësimin profesional.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti mbështet të gjitha projektet kërkimore-shkencore që lidhen me fushën e së drejtës në përgjithësi dhe në fushën civile dhe atë të biznesit në vecanti, kryesisht nga personeli akademik në publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare apo edhe pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe në angazhimin e studentëve në forume diskutimesh akademike. Bashkëpunimi koordinohet edhe me institucione të tjera, apo organizata që ushtrojnë veprimtari në fushat përkatëse. Projektet kërkimore pranë departamentit zhvillohen edhe në trajtën e tezave të doktoraturave të cilat miratohen dhe ndiqen në nivel UET. UET ka revistat e saj Polis, Economicus, Medicus. Fakulteti organizon aktivitete kërkimore-shkencore leksione të hapura ose forume diskutimi, në ndihmë të studentëve për të paraqitur punën e tyre kërkimore, ide, komente, qasje, analiza, etj. Lëndët dhe kurrikulat e programit janë në përputhje me aktet e BE dhe reflektojnë elementë ndërkombëtarë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
---------------------------------	------------	-------------------	-------------------	-------------------

standardeve të fushës II	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në ciklin e II-të studimeve Master i Shkencave në në 'E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi", stafi akademik i angazhuar ndjek me rigorozitet përcaktimet në kuadrin ligjor e rregullator mbi format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të njohurive. Bazuar në Rregulloren e departamentit, në këtë cikël studimesh format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive përfshijnë: leksione, seminare/orë laboratorike, detyra/projekte kursi, praktike profesionale, tema diplome/provim formimi. Çdo vit akademik, departamenti i Shkencave Juridike përgatit dosjen e plotë të programit të studimit. Në dosje përfshihen planet mësimore, struktura e vitit akademik, planet e ngarkesave mësimore, planet kalendare, plani i performancës akademike, etj. Në takimin që zhvilloam me personelin akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesshme, si dhe nga takimi me studentë dhe ish-studentë, u informuam se aplikohen të gjitha format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, që janë konkretisht leksionet, seminarët, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe forume të ndryshme.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese MSH E DREJTË PRIVATE BIZNESI (Aneks_Tabela 9);</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të</p>	<p>Personeli akademik jo vetëm respekton dhe i përgjigjet nevojave të larmishme të studentëve, me të gjitha format dhe metodat tradicionale dhe moderne të mësimdhënies e</p>

<p>studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>mësimnxënies, por edhe u ofron atyre mundësinë të bashkëpunojnë në punime dhe prezantime shkencore e praktike që lidhen me fushën e të drejtës private dhe atë të biznesit, të cilat i aftësojnë ata të përballen me profesionalizëm dhe dije me tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik u informuam se UET organizon trajnime periodike të stafit (staff development Day) lidhur me teknikat e mësimdhënies, mësimnxënies, projektet, etj, si dhe u mundëson atyre pjesëmarrje aktive në aktivitete ndërkombëtare shkëmbimi apo Erasmus.</p> <p><i>Ref. Dokumenti Nr. 28. Të dhënat mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit;</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>UET në përgjithësi ka pikë të fortë të tij përdorimin e metodave interaktive me qendër studentin, nxit mendim kritik dhe atë krijues, autonominë dhe elouencën të studentët e tij në përgjithësi, në mënyrë të vecantë edhe tek studentët e programit Master i Shkencave’ në ‘E Drejtë Private dhe Biznesi’ me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi.</p> <p>Nga të gjithë IAL që operojnë në Shqipëri, UET është prej vitesh lider në krijimin e kontakteve mediatike dhe vizibilitetit të studentëve të saj të tashëm dhe atyre alumni. Programi gjithashtu siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes studentëve dhe personelit të IAL në të gjitha dimensionet e tyre, pasi një pjesë e personelit akademik janë ish-student të UET, që jo vetëm përcojnë traditën por edhe kuptojnë më mirë nevojat e tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies përbën procesin që ndiqet, monitorohet e kontrollohet me shumë kujdes si për mbarëvajtjen ashtu dhe në aspektin cilësor. Metodatat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen dhe përdoren për programin e studimit Master shkencor janë të shumëllojshme.</p> <p>Departamenti vlerëson dhe përmirëson vazhdimisht teknikat e mësimdhënies, duke pasur në focus studentët e programit, nëpërmjet pyetësorëve në cdo lëndë ose nëpërmjet komunikimeve periodike për këtë qëllim, nga NJSBC dhe Departamenti. Kontrollat e realizuara nga departamenti dhe</p>




	<p>dekanati (leksione të hapura) lidhur me disiplinën në procesin mësimor konstatojnë si konkluzion të përgjithshëm, zhvillimin me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve të këtij programi studimesh. Institucioni përmes pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura të asamblesë ndërgjegjëson studentët dhe personelin për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet. Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të drejtpërdrejta si sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve dhe sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Sipas Statutit të UET (neni 16) Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel IAL ka rolin e dedikuar për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë në të gjitha programet e UET, përfshirë edhe Programin Master i Shkencave’ në ‘E Drejtë Private dhe Biznesi’ me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi, në koordinim të plotë me Departamentin, me stafin që drejtojnë projektet dhe trajnimet.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 2. Statuti UET_ struktura organizative aktuale;</i> <i>Ref. Dokumenti 30.1. Plani veprimi KSBC;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UETaplikon të gjitha format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, që janë konkretisht leksionet, seminarët detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe forume të ndryshme. Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet nevojave të larmishme të studentëve, me të gjitha format dhe metodat tradicionale dhe moderne të mësimdhënies e mësimnxënies dhe u ofron atyre mundësinë të bashkëpunojnë në punime dhe prezantime</i></p>

	<p><i>shkencore e praktike që lidhen me fushën e të drejtës private dhe atë të biznesit, të cilat i aftësojnë ata të përballen me profesionalizëm dhe dije me tregun e punës.</i></p> <p><i>UET në përgjithësi ka pikë të fortë të tij përdorimin e metodave interaktive me qendër studentin, nxit mendimik kritik dhe atë krijues, autonominë dhe elouencën të studentët e tij në përgjithësi, në mënyrë të vecantë edhe tek studentët e programit Programi gjithashtu siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjelltë mes studentëve dhe personelit të IAL në të gjitha dimensionet e tyre, pasi një pjesë e personelit akademik janë ish-student të UET, që jo vetëm përcojnë traditën por edhe kuptojnë më mirë nevojën e tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren e studimeve të UET, në rregulloren e Fakultetit si dhe në rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu ato janë të përcaktuara në programet e çdo moduli. Të gjithë këta elementë i bëhen të ditura studentëve dhe janë të publikuara në ëbsite individuale të secilit prej pedagogëve të lëndëve në syllabuset e përditësuara të lëndëve. Nota përfundimtare e studentëve vjen nga disa element, provimi i ndërmjetëm, detyrë kursi, niveli i diskutimit në seminare apo detyra praktike, provimi përfundimtar. Studentit i ofrohet shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm nga Koordinatorja e departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 5. Rregullore e UET;</i></p>

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse, e parashikuar kjo nga syllabusi i cdo lënde. Struktura e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara gjatë zhvillimit të modulit bëhet në një ndarje prej vlerësimit i vazhduar dhe provimit përfundimtar. Në vlerësimin e vazhduar përfshihen forma të ndryshme testimi si provime të pjesshme, detyra kursi/projekte që mund të jenë individuale ose në grup, si dhe aktivizimi dhe ndërveprimi aktiv gjatë zhvillimit të seminareve.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit kryehet përgjatë të gjithë ciklit të zhvillimit të lëndëve, me qëllim që të nxisë studentin të përgatitet gjatë gjithë vitit, të mundësojë një vlerësim më objektiv të tij, në disa komponentë dhe jo në një provim të vetëm, dhe për të marrë kuptuar edhe ecurinë e njohurive përgjatë të gjithë kursit.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqipika 5.2;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni harton rregullore dhe procedura të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. Studentët informohen paraprakisht me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, ne perputhje me rregulloet e IAL.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë</p>	<p>Rregullorja e institucionit, që përcakton mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive të studentit, parashikon forma të ndryshme, sipas kriterit të “kontrollit të vazhdueshëm”.</p>




<p>gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Elemente kryesore të tij janë provimet, detyrat e kursit apo detyrat praktike, aktivizimi në seminare. Në këtë mënyrë, duke e ndarë vlerësimin në disa komponentë, synohet objektiviteti dhe efektiviteti më i mirë i testimit.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 5. Rregullore e UET</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar RVB, UET në bashkëpunim me AADF Albanian-American Development Foundation po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik - clean score. Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme: si në nivelin bachelor dhe master, kur ka qenë e mundur, sipas karakterit të lëndës.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Edhe vlerësimi përfundimtar i njohurive parashikohet nga Rregullorja e programit të studimit MSH E Drejtë Private dhe Biznesi dhe në secilin syllabus të lëndës.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore MSH E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vizitave në institucion, u konstatua se pas zhvillimit të provimeve dhe publikimit të rezultateve, pedagogët diskutojnë me studentët mbi zgjidhjen e tij, duke ndikuar në përmirësimin e dijeve në vijim. Në pikën 5.3.4 të Rregullores Mësimore të programit të studimit përcaktohet se: "... seancat sqaruese, ku pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin".</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore MSH E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Institucioni dhe strukturat përgjegjëse marrin disa masa për evitimin e kopjimit dhe përdorimin e plagjaturës në realizimin e detyrave të kursit apo punimit të diplomave. Më konkretisht në evidencen 7.2, "A.IV Sistemi i Vlerësimit të Studentëve" pika A.IV.2.6 dhe A.IV.2.7 lidhen me masat që ndermerren në këto raste. Këto masa lidhen me mënyrën sesi zhvillohet provimi duke patur dy ose dhe më shumë personel akademik me funksion mbikqyrës, njoftimin e studentëve për rregullat e sjelljes dhe të komunikimit në sallën e provimit, me moslejimin e përdorimit të mjeteve të komunikimit si dhe në rast të konstatimit të kopjimit masa ndëshkimore është e lartë.</p>





	<i>Ref. Dokumenti 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve;</i>			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Koha e dorëzimit të provimeve është e përcaktuar në Rregulloren e UET dhe dokumentave të tjera. Brenda dy javëve nga data e zhvillimit të provimit stafi akademik duhet të realizojë korrigjimin dhe seancat sqaruese. <i>Ref. Dokumenti 5. Rregullore e UET</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	E drejta për tu njohur me vlerësimin është e përcaktuar në Rregulloren e Institucionit dhe Programit të Studimit. Institucioni ka ndërtuar procedura për garantimin e kësaj të drejte si për transparencën e vlerësimit dhe për shqyrtimin e ankesave në rastet kur student nuk është i bindur për vlerësimin e marrë. Në këto raste Drejtuesi i Departamentit ngrë komision me staf akademik që janë njohës të lëndës dhe realizojnë procedurën e rishikimit të vlerësimit duke e dokumentuar atë. <i>Ref. Dokumenti 5. Rregullore e UET;</i> <i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Procedura e ankimimit realizohet bazuar në nenin 32 të Rregullores së UET e cila saktëson procedurën si vijon: "...Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngrë një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar." Procedura dokumentohet dhe arkivohet. <i>Ref. Dokumenti 5. Rregullore e UET;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent të studenteve. Ky vlerësim bazohet në meritën e çdo student. Studenteve u jepet e drejta e ankimimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe

synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit garanton thellimin të njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale apo të veçanta të studentëve pasi në cdo kurrikul të lëndëve të zhvilluara parashikohen analiza të thelluara shkencore dhe profesionale, si dhe analiza të shumta të rasteve praktike. Gjithashtu bashkëpunimi me studentët në aktivitete shkencore, pjesëmarrja në gjyqe imituese apo klube studentore ku diskutohen publikisht çështje të së drejtës civile dhe private jo vetëm thellon njohuritë por i mundëson atyre aftësim në public speech pra të folurit public qe studentët e UET e kanë të spikatur, në dallim nga universitetet e tjera.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Sic u përmend edhe më sipër, angazhimi i studentëve në aktivitete profesionale nën mentorimin e pedagogëve dhe stafit mbështetës, u mundëson atyre zhvillimin e aftësive humane, të teknologjisë dhe ndërveprimit, edhe në gjuhë të huaj në ditët e sotme njohja e gjuheve të huaja sidomos të gjuhës angleze dhe njohuritë në fushën e IT janë të zakonshme nga studentët. Në kategorinë “A” ofrohen njohuri mbi metodat e kërkimit, gjë që i ndihmon studentët në kryerjen e punimeve shkencore. <i>Ref. Dokumenti 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese MSH E DREJTË PRIVATE BIZNESI (Aneks_Tabela 9);</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.	Aftësitë dhe njohuritë që përftohen në fund të cdo lënde dhe programit, vihen në pah që në fillim të lëndës nga vetë pedagogu dhe student orientohet për tu fokusuar drejt tyre përgjatë kursit. Gjithashtu zhvillimi i aktiviteteve profesionale me profesionistë të spikatur të fushave të së drejtës private që japin kontribut në institucione të drejtësisë dhe më gjerë, u mundëson atyre një kuptim më të thelluar e të plotë të çështjeve më të rëndësishme. Gjithashtu përpara së të zhvillohet provimi përfundimtar, studentët informohen për çështjet kryesore. <i>Ref. Dokumenti 30.12. Shembull_Relacion DSHJ_Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022;</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra	Zhvillimi i procesit të mësimdhëniës realizohet mbi bazën e kompetencave duke lidhur punën individuale të studentit për realizimin e detyrave të kursit sëbashku me njohuritë e përfuara gjatë procesit mësimorë nga lektori përkatës.

<p>në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Studentët kanë mundësi reale për të zhvilluar njohuritë e marra në auditor në praktika profesionale, të cilat janë të organizuara dhe koordinuar në rang programi dhe UET, në bashkëpunim me një sërë institucionesh të drejtësisë dhe profesione të lira, sipas interesit dhe referencave të gjithsecilit. Për këtë UET ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të administratës shtetërore dhe institucione të tjera, zyra avokatie, noterie, etj.</p> <p>Në këtë këndvështrim <i>do të sugjerohej që të zhvilloheshin edhe vizita në gjykata të ndryshme, për të parë nga afër si zhvillohet një process gjyqësor civil, ose edhe me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit apo studio që ofrojnë konsulencë në fushën e arbitrazhit tregtar.</i></p> <p>Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve. Leksionet, realizohen në mënyrë interaktive ku ndërthurin dijen teorike me atë praktike. Gjatë orëve të seminareve studentët organizohen shpeshherë në punë në grup për të diskutuar mbi çështje specifike, ndërsa ofrohen raste studimore për të identifikuar zgjidhjet e problematikave të caktuara. Në këtë mënyrë, studentët pajisen me aftësi dhe kompetenca për identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet me personelin akademik u informuam se ata ndjekin zhvillimet e shkencës të së drejtës, kryesisht online nëpërmjet informacionit që institucionet e rëndësishme të drejtësisë shpërndajnë në faqet e tyre të internetit si GJED, GJEDNJ, etj. UET ka miratuar Strategjinë e Kërkimit Shkencor e cila parashikon mundësi zhvillimi të stafit - gjithashtu në UET ka programe në bashkëpunim me IAL të huaja nëpërmjet programeve ERASMUS apo programeve të tjera të përbashkëta të studimit (joint degree), <i>megjithatë ka një numër të vogël mobilitetesh të stafit të programit, gjë që do të rekomandim të përmirësohej në të ardhmen.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>UET nxit studimet e thelluara kërkimore nga studentët, të cilët nën mentorimin e pedagogëve të tyre apo në disa raste edhe të ekspertëve të ftuar nga UET realizojnë kërkime të thelluara në fushën e së drejtës private, megjithatë nuk u raportuan raste ku studentët kanë përfituar grante për këtë qëllim.</p>




Konkluzione	<i>Programi përgjithësisht garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët që synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek ta në të ardhmen do të sugjeronim që IAL të ketë më tepër fokus të grantet e financimit të kërkimeve të thelluara të personelit akademik dhe të studentëve për çështje që vlerësohen prioritare në fushën e së drejtës civile.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në aktet e brendshme rregullatore, është përcaktuar procedura e posaçme për diplomimin, si për rastet e punimit të temës së diplomës, ashtu edhe provimit të diplomimit. Në nivel institucioni, Universiteti ka një dokument të cilësuar: “Mbi punimin e diplomës/disertacionit” B.II i cili kategorizohet si “manual procedure” dhe përshkruan procedurën e posaçme vetëm për realizimin e diplomës dhe mbrojtjes së saj. <i>Ref. Dokumenti 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Njoftimet mbi detyrimet, përveçse shpallen në faqen e universitetit ato dërgohen edhe me email nga sekretaria e departamentit, pasi studentët pajisjen me një email të IAL kur ata fillojnë studimet pranë UET-së. Gjithashtu detyrimet e mbrojtjes së praktikës profesionale dhe më pas të punimit të temës së diplomës vendosen edhe në stendat dhe janë të aksesueshme nga të gjithë. Personeli akademik asiston studentët nëpërmjet seancave metodologjike, sipas një kalendari të caktuar dhe shpallur paraprakisht, duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme. <i>Ref. Dokumenti 5. Rregullore e UET;</i> <i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i>

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studentët e këtij program studimi, kryejnë detyrimet përmbyllëse vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës, duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studenti punon temën e zgjedhur nga vetë ai nën mbikëqyrjen e një pedagogu udhëheqës dhe bën mbrojtjen e saj përpara komisionit të mbrojtjes së diplomave.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës zhvillon seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq, të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Pedagogu udhëheqës e orienton dhe ndihmon studentin jo vetëm në përcaktimin e temës së diplomës, por për çdo vështirësi me të cilin student ndeshet gjatë punës së tij. Udhëheqësi i zhvillon seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq, të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës.</p> <p>Cështjet që diskutohen lidhen ndër të tjera me objektin e studimit dhe dobinë e tij, formulimin e temës së diplomës dhe strukturës, përcaktimin e hipotezave, evidentimi i burimeve dhe materialeve mbështetëse dhe mënyra e shkrimit / paraqitjes së tyre në document – referencat dhe bibliografia, deri në hartimin e draftit përfundimtar. Diploma para se të dorëzohet për mbrojtje duhet të marrë nënshkrimin e pedagogut udhëheqës.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 5. Rregullore e UET;</i> <i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore_MSH_E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në statutin e UET Neni 50 sanksionohen të drejtat dhe detyrimet e studentit. Institucioni i mbështet studentët me infrastrukturën që ka për ti asistuar në realizimin e punës kërkimore. Roli i pedagogut është i rëndësishëm sidomos për përcaktimin e metodologjisë dhe instrumentave të kërkimit.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale;</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes</p>	<p>Referuar RVB, komisioni vlerëson me notë diplomat nota është mesatarja aritmetike e vlerësimeve individuale të cdo anëtari të komisionit.</p>

së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.									
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar nenit 40 të Rregullores së UET, në përfundim të studimeve në programin Master i Shkencave' në 'E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë Biznesi, studentët pajisen me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Pasi ka përfunduar të gjitha detyrimet ndaj institucionit studentët pajiset me diplomë brenda një afati prej 6 muajsh. <i>Ref. Dokumenti 5. Rregullore e UET;</i>								
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore, menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve, që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databazën e Sekretarisë Mësimore, si dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria Mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentet e çdo studentit që është i regjistruar, është çregjistruar, si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre. <i>Ref. Dokumenti 5. Rregullore e UET;</i>								
Konkluzione	<i>UET ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. Të dhënat ruhen në databazë dhe arkivohen për një periudhë të paacaktuar.</i>								
Shkalla e përmbylljes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbyllet</th> <th>Përmbyllet pjesërisht</th> <th>Përmbyllet kryesisht</th> <th>Përmbyllet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht				X
Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht						
			X						

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësitë

përgjegjëse, në funksion të

Praktika mësimore në programin Master i Shkencave' në 'E Drejtë Private dhe Biznesi' me profile E Drejtë Private, E Drejtë

<p>mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Biznesi realizohet nga institucionet pritëse, në marrëveshje me UET. Krahas kësaj, e gjithë infrastruktura është realizuar në funksion të mësimdhënies me akses në rrjetin kompjuterik dhe internet.</p> <p><i>Ajo që mund të sugjerohet është krijimi i një salle gjyqi imitues brenda UET, ndoshta edhe në bashkëpunim me donatorë të tjerë për të lehtësuar kostot e krijimit.</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Sic u parashtrua edhe më sipër, ky komponent realizohet në bashkëpunim me institucione të shumta të administratës shtetërore dhe entitete private në marrëveshje paraprake me UET, në ambientet e tyre. Më pas praktika mësimore ndiqet edhe nga pedagogët mbikqyrës që vlerësojnë ecurinë dhe raportin në përfundimin e saj, ajo që mund të sugjerohet në këtë kontekst është rritja e bashkëpunimit me institucione në fushën e drejtësisë gjykata, prokurori, ose edhe vizita të organizuara në trajtën e një Open day.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 34. Marrëveshjeve të Bashkëpunimit UET;</i></p>
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Rregullorja e Studimeve të Programit të Studimit MSH E drejte private dhe biznesi parashikon vlerësimin e studentit bazuar tek dosja e praktikës që ai dorëzon, shoqëruar edhe me vlerësimin e pedagogut përgjegjës pranë Koordinatorës së Departamentit, me formularin e vlerësimit të studentit nga institucioni/entiteti ku është kryer praktika, me formularin e vetëvlerësimit të plotësuar nga studenti dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga vetë student. Vlerësimi përfundimtar realizohet nga një komisioni i ngritur për këtë qëllim.</p> <p><i>Ref. Dokumenti 7. Rregullore MSH E drejte private dhe biznesi – shqip;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UET ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikave në institucione me të cilat UET ka nënshkruar paraprakisht marrëveshje, të parashikuara në Rregulloren e programit. Ajo që rekomandohet në këtë drejtim është rritja e bashkëpunimit me institucione në fushën e drejtësisë gjykata, prokurori, ose edhe vizita të organizuara në trajtën e një Open day si dhe krijimi i një salle gjyqi imitues për</i></p>

	<i>të gjithë studentët që ndjekin programin e drejtësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Sikurse është sqaruar dhe në seksionin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga akreditimi i mëparshëm, për 5 vitet akademike në vlerësim, të dhënat për gradat dhe titujt e pedagogëve, titullarë të lëndëve të këtij programi studimi, paraqiten si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Në vitin akademik 2018-2019, kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët 8 PAE dhe 2 PAK; ✓ Në vitin akademik 2019-2020, kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 3 PAK; ✓ Në vitin akademik 2020-2021, kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 4 PAK; ✓ Në vitin akademik 2021-2022, kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 4 PAK;

Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	1	1	1	2	-	1	-
Prof. Asoc.	3	1	2	-	-	1	2	1
Dr./PhD.	4	-	5	-	5	2	4	3
Msc.	1	-	3	2	3	1	3	-
Totali	8	2	11	3	10	4	10	4

Sipas përcaktimeve ligjore (*pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015*), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi Master i Shkencave, angazhohen edhe staf akademik me Msc.

GJV rekomandon që, për realizimin e programit të studimit MSH.Dr.P.B, Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.

Ref. Dokumenti 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB MSHDRPB;

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Për 3 vitet e fundit akademike, mbulimi i ngarkesës mësimore të programit të studimit, nga stafi akademik efektiv, paraqitet si më poshtë (*Ref. Pika 4, dokumenti nr.38*):

- Për vitin akademik 2021- 2022, ngarkesa totale mësimore e programit, e mbuluar nga personeli akademik efektiv është 76%, ndërsa ngarkesa e mbuluar nga personeli akademik me kontratë është 24%;
- Për vitin akademik 2021- 2022, ngarkesa totale mësimore e programit, e mbuluar nga personeli akademik efektiv është 76%, ndërsa ngarkesa e mbuluar nga personeli akademik me kontratë është 24%.
- Për vitin akademik 2022-2023, ngarkesa totale mësimore e programit, e mbuluar nga personeli akademik efektiv është

	<p>79%, ndërsa ngarkesa e mbuluar nga personeli akademik me kontratë është 21%.</p> <p>Plotësohen kështu kërkesat ligjore në lidhje me mbulimin e ngarkesës nga stafi akademik efektiv. Personeli akademik në UET kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UET, këshillim për studentët, tutoriat si dhe veprimtari të tjera.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga verifikimi me zgjedhje rezulton se në dosjen e çdo anëtari të stafit akademik të IAL-së, administrohet dokumentacioni personal dhe kontrata individuale të punës.</p> <p>IAL rezulton të ketë paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>(Ref. Dokumenti nr.44.1)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara në dokumentet e brendshme të institucionit.</p> <p><i>(Ref. Dokumenti nr.11)</i></p> <p>Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim nëpërmjet pyetësorëve. Shpallja e njoftimit për rekrutim të stafit akademik bëhet transparente në faqen zyrtare të UET.</p> <p><i>(Ref. Dokumenti nr.11.1)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>IAL (UET) aktualisht ka në dispozicion një kampus të ri universitar, ku u realizua edhe vizita e GVJ. Në dispozicion të veprimtarisë akademike janë disa godina, ku janë të shfrytëzueshme 15 salla leksionesh dhe 13 salla seminaresh.</p> <p><i>(Ref. Dokumenti Nr.42 dhe Dokumenti Nr.42.1).</i></p>

<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh dhe administron të dhënat e personelit akademik, më kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme. Për çdo anëtar të stafit ka dosje individuale. Gjithashtu nga kjo zyrë mbahet edhe evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore.</p> <p><i>(Ref. Dokumenti nr.11; nr.44.1 dhe nr.44.2)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sikurse evidentohet edhe në rubrikën e plotësimin të rekomandimeve të lëna nga akreditimi i mëparshëm, Institucioni (UET) ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe dhe shoqëri të biznesit vendas ose të huaj, duke lidhur marrëveshje me këto subjekte. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve ka qënë realizimi i objektivave të programeve të studimeve, duke siguruar marrëdhënie bashkëpunimi për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës<i>(Ref. dokumenti nr.35)</i>. Në këtë mënyrësigurohet akomodimi i studentëve në këto institucione dhe zhvillimi i rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale në UET. Sigurimi i institucionit për zhvillimin e praktikës profesionale është detyrim i studentit, i cili mund të shfrytëzojë edhe asistencën e Zyrës së Këshillimit të Karrierës për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikës. Departamenti e miraton aplikimin e studentit nëse zhvillimi i praktikës në institucionin e propozuar nga studentit përputhet me objektivat e programit të tij të studimit. Mbikëqyrja dhe ndjekja e seancave kryhet nga një pedagog, i caktuar nga departamenti, i cili ka edhe statusin e këshilluesit të karrierës<i>(Ref. Dokumenti nr.32.1)</i>. Për studentët të cilët kryejnë një punim diplome, për të përmbyllur detyrimet e tyre departamenti vë në dispozicion të studentëve, stafin akademik të kualifikuar, për t'i udhëhequr gjatë realizimit të saj <i>Ref. Dokumenti nr.10 "Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit"</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin</p>	<p>Institucioni ku zhvillohet praktika, bazuar në marrëveshjet e nënshkruara, në lidhje me praktikat profesionale, ka këto</p>

<p>pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>detyrime (Ref. Dokumenti nr.32.1):</p> <ul style="list-style-type: none"> -T'i ofrojë studentit mundësi për përfitim eksperience në punë; -T'i ofrojë studentit informacion për mjedisin e punës dhe për punën konkrete ku do të angazhohet studentit praktikant; -Të ngarkojë një mbikëqyrës për çdo student, i cili të kujdeset dhe ta orientojë atë; -Mbikëqyrësit i lind detyrimi të plotësojë formularin e vlerësimit të studentit dhe t'ia dorëzojë atë pedagogut mbikëqyrës në afatin e vendosur; -Të bashkëpunojë me pedagogun mbikëqyrës për zgjidhjen e problemeve që mund të hasen gjatë praktikës; 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni garanton qëndrueshmëri në rekrutimin e personelit akademik, si dhe ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Institucioni lidh marrëveshje me institucione, apo organizma të tjera, për të siguruar ambientin e nevojshëm për realizimin e praktikave profesionale, të cilët e aisojnë studentin në zhvillimin e këtyre praktikave. Për realizimin e programit të studimit në proces vlerësimi, Institucioni duhet të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë</p>	<p>Universiteti European i Tiranës ndodhet me seli në adresën: Rruga Xhanfize Keko, Nd. 56 Tiranë. UET ka në dispozicion 4 godina ku zhvillohet procesi akademik dhe 4 godina me ambiente teknike shërbimi. Sipërfaqja totale e godinave të</p>

<p>mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Universitetit është rreth 7,545 m². Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 15 salla me sipërfaqe totale 1447 m² dhe 1138 vende. Salla seminari janë gjithsej 13, me sipërfaqe 561 m², dhe 353 vende.</p> <p><i>Ref. Dokumenti Nr. 42; Ref. Dokumenti Nr. 42.1</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Sallat mësimore për leksione dhe seminare janë pajisura me mjete elektronike (kompjuterat dhe videoprojektorë). Gjithashtu janë në përdorim sisteme të teknologjisë së informacionit (softëare) për të ndihmuar në realizimin e procesit mësimor. Nga pedagogët dhe studentët përdoret sistemi MOODLE (UET LMS).</p> <p><i>Ref. Vizita ne IAL.</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti Nr. 46.1 Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS;</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 46.2 UET-LMS Guidë për pedagogun; 46.3 UET_LMS Guidë për studentë;</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Mjediset që institucioni ofron përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit.</p> <p><i>Ref. Vizita ne IAL.</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>IAL aktualisht ka funksional më shumë se 1 një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me PC dhe mjete audio vizive.</p> <p><i>Ref. Vizita ne IAL.</i></p> <p><i>Ref. Dokumenti 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që</p>	<p>Në kuadër të mbarëvajtjes së realizimit të programit të studimit UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione që</p>

<p>zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>ushetrojnë veprimtari në fushën e drejtësisë, akademisë, mbrojtjes juridike, dhe administratës publike.</p> <p>Me 32 institucioneve, bashkëpunimet janë formalizuar zyrtarisht përmes akt-memorandumeve apo marrëveshjeve. UET ka një udhëzues, i cili u vjen në ndihmë studentëve "Mbi praktikën profesionale".</p> <p><i>Ref. Dokumenti Nr. 32;</i> <i>Ref. Dokumenti Nr. 34.1 – 34.27;</i> <i>Ref. Dokumenti Nr. 32.1;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UET ka në dispozicion ambjentë të mjaftueshme për zhvillimin e procesit akademik. Mjediset mësimore janë të pajisura me mjete audio vizive, si: PC, projektore, foni dhe internet. UET garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion sikurse dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale)</p>	<p>Literatura e lëndës është e përcaktuar në syllabusin përkatës. Në të përcaktohet literatura bazë dhe ajo ndihmëse, e cila kryesisht është në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të huaj. Kjo literaturë është e mjaftueshme për studentët për të marrë dijet dhe</p>




garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	njohuritë e nevojshme.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Njësia bazë përgjegjëse paraqet kërkesat për literaturën e nevojshme për lëndët e programit, ku përfshihen “Tekste bazë”, “Tekste të rekomanduara”, “Tekste plotësuese”. <i>Ref. Dokumenti nr.45.2;</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e institucionit është në dispozicion të të gjithë studentëve, përfshirë edhe studentët e programit MSH “E Drejtë Private dhe Biznesi”. <i>(Ref. Dokumenti nr.45.1).</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita në bibliotekë rezultoi se ajo përmban shumë tekste (libra) me natyrë juridike, në shqip dhe gjuhë të huaj. Fondi i bibliotekës është i përbërë nga libra, tekste leksionesh, monografi, revista, periodikë. <i>(Ref. Dokumenti Nr. 45);</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco dhe Questia.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të	Studentët mund ta aksesojnë literaturën juridike edhe në libraritë elektronike, nëpërmjet PC të vendosura në bibliotekë.

<p>tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i shërbimit në Bibliotekë është i përcaktuar në mënyrë të tillë, që studentët të sigurojnë akses në të: e Hëne-Premte 9:00-20:00; e Shtunë 9:00-17:00.</p> <p><i>(Ref. Dokumenti Nr. 45.1, pika E.IV.2.8).</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Botimet dhe literatura fizike përditësohet nga IAL, duke e pasuruar fondin e bibliotekës <i>(Ref. Dokumenti Nr. 45.3).</i></p> <p>Në dokumentat rregullatore parashikohet procedurat e pasurimit të bibliotekës.</p> <p><i>(Ref. Dokumenti Nr. 45.1; Pika E.IV.4).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në syllabuset e lëndëve janë vendosur literatura bazë dhe ajo ndihmëse. Biblioteka e institucionit është e aksesueshme dhe për studentët e programit MSH E Drejtë Private dhe Biznesi. UET ka siguruar kapacitetet infrastrukturore të mjaftueshme në bibliotekë, ofron akses fizik për studentët, si dhe ka siguruar mundësinë qëata të lexojnë edhe në bibliotekat on-line. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4


Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET ka vënë në përdorim sistemin UMIS, një program informatik, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Sistemi UMIS ofron specifikisht <i>Sistemin e Menaxhimit të Studentit</i> , i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, së bashku me rezultatet e provimeve ndër vite. (Ref. dokumenti Nr. 46 dhe Nr.46.1)
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Informacioni akademik dhe ai administrativ e financiar ruhet, perpunohet dhe raportohet nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Nëpërmjet këtij sistemi bëhet e mundur informimi i studentëve mbi materialet didaktike, të nevojshme për zhvillimin e mësimi (leksionet), mundësohet komunikimi midis tyre dhe pedagogëve, si dhe merret informacion mbi vlerësimin e vazhduar dhe notat. (Ref. dokumenti Nr. 46)
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, sigurohet informacion për të gjithë personelin akademik dhe studentët. Në të gjenden edhe aktet rregullatore të IAL-së.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që	Aktualisht studentët dhe pedagogët kanë në përdorim platformën UET LMS (Learning Management System), i cili ruan dhe administron të gjithë informacionin mbi lëndët, materialet

<p>mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>didaktike dhe vlerësimet e studentëve.</p> <p>Ky sistem siguron mundëinë e komunikimit dhe të shkëmbimit të materialeve të studimit mes pedagogëve dhe studentëve.</p> <p><i>Ref. dokumenti Nr.46.2; Nr.46.3; Nr.46.4</i></p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit siguron gjenerimin e raportimeve me të dhëna statistikore mbi aktivitetin akademik dhe administrativ të institucionit.</p> <p><i>(Ref. dokumenti Nr.46.5 dhe Nr.46.6).</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Institucioni siguron transparencën e aktivitetit të tij, nëpërmjet faqes së tij zyrtare: www.uet.edu.al</p> <p>Faqja zyrtare është në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe siguron informacion mbi misionin e institucionit, programet e studimit, stafin akademik, informacione për studentët. Informacion që përmbahet në faqë percaktohet nga një dokument rregullator specifik.</p> <p><i>(Ref. dokumenti Nr. 48).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UET ka vënë në përdorim sisteme të informatizuara, nëpërmjet të cilave administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, lehtëson komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit, duke rritur cilësinë së mësimnxënies, si dhe shërben edhe për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni harton dhe miraton buxhetin e tij periodikisht. Raportimet financiare (të ardhurat-shpenzimet) hartohen në nivel institucional dhe jo programi studimi.</p> <p><i>(Ref. dokumentet Nr. 50.1 – 50.3)</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>UET nuk ka plan të financimit të njësisë bazë, por e harton këtë plan në nivel institucional. Nuk ka plane dhe raporte në bazë të programeve të studimit, pasi infrastruktura dhe stafi janë të angazhuar në programe të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UET ka kryerprocedurat e auditimit të pasqyrave financiare çdo vit nëpërmjet auditimit të pasqyrave financiare të shoqërisë “EUROPIAN EDUCATION INITIATIVE”- EEI shpk. Çdo vit është hartuar raport në lidhje me transparencën financiare. <i>(Ref. dokumenti Nr. 50.5 – 50.7)</i></p> <p>Në pasqyrat financiare të çdo viti, audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën</p>




	dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. (Ref. dokumentet Nr. 50.1 – 50.4)			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Duke qënë se institucioni nuk harton plan të financimit për njësi bazë (department), nuk mund të analizojë realizimin e buxhetit deri në nivelin e njësisë bazë.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<p><i>Pasqyrat Financiare</i> të certifikuara përmbajnë të dhënat financiare për të gjithë institucionin dhe që dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare gjatë kohëzgjatjes së programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit në vlerësim (sikurse dhe programet e tjerë të studimit të ofruar nga IAL) ka si burim kryesor të financimit tarifat e studimit të paguara nga studentët.</p>			
Konkluzione	<p><i>UET nuk harton plan financimi (të ardhura dhe shpenzime) për programin e studimit në proces akreditimi, por e harton këtë plan vetëm në nivel institucional, si IAL. UET harton dhe zbaton buxhetin financiar duke mbajtur në konsideratë shpenzimet dhe nevojat për realizimin e të gjithë programeve të studimit, që ofron IAL-ja. Pasqyrat financiare, të audituara nga audites të certifikuar, dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------




				X
--	--	--	--	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Procesi i pranimit të studentëve është, sa i përket politikave dhe kriterëve të pranimit, është i rregulluar në një document të veçantë. Këto parime dhe kriterë mbështeten në legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloret përkatëse. <i>(Ref. Dokumenti Nr. 27.1)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni i ka të përcaktuara kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e të gjithë programeve të studimit, që ai ofron. <i>(Ref. Dokumenti Nr. 5)</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kriteret specifike për pranimin e studentëve janë propozuar nga Departamenti dhe janë miratuar me Vendim të Senatit Akademik për programin e studimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, janë bërë publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit të studentëve gjendet online në adresën http://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/ , si dhe në broshurën informuese (Guida UET).
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së	UET ka hartuar dhe miratuar, në dokumenta specifike, kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve,

<p>studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>transferimit të krediteve, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit. Këto dokumenta janë të kuptueshme dhe të aksesueshme, për të garantuar transparencë të plotë. Ato janë të aksesueshme online dhe i bëhen të ditura të interesuarve gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Dokumenta të tilla janë:</p> <p>"Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin" (Ref. Dokumenti Nr.28);</p> <p>Dokumenti "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit" (Ref. Dokumenti Nr.12);</p> <p>Dokumenti "Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik" (Ref. Dokumenti Nr. 27.2);</p> <p>"Rregullore mësimore MA "E drejtë private dhe biznesi" (Ref. Dokumenti Nr. 7).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UET ka hartuar dokumentin "Politika e marketingut të programit të studimit" dhe "Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online", të cilat përmbajnë informacion të plotë lidhur informimin për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në UET. Nëpërmjet fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit, si <i>Gjinnaztour</i>, këshillimi në hollin e UET gjatë periudhës së regjistrimeve, etj, ka realizuar udhëzimet e studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të regjistrimit në programin e MSH E Drejtë Private dhe Biznesi.</p> <p>Ref. Dokumenti Nr. 51); (Ref. Dokumenti Nr. 48</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>IAL nuk miraton kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>IAL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. (psh kriteret: <i>Nëse diploma e kandidatit është lëshuar nga një institucion i huaj, duhet të shoqërohet me vërtetimin e njohjes dhe njësisimit nga QSHA-ja; Studentët me shtetesi të huaj duhet të dorëzojnë gjuhën shqipe të mbrojtur në Universitetin e Tiranës).</i></p>

	https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	IAL ofron bursa të plota ose të pjesshme të studimit, mbi bazën e disa kriterëve përzgjedhjeje me synimin për të nxitur cilësinë në hyrje të studentëve, si dhe për t'u ardhur në ndihmë shtresave në nevojë.			
Konkluzione	<i>Politikat, kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, janë të parashikuara në dokumenta të posaçme, si dhe janë të publikuara edhe on line. Këto dokumenta përmbajnë informacion të plotë lidhur informimin për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në UET. UET ka hartuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në programin e studimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. UET ka formuluar dhe zbaton politikë të akordimit të bursave. <u>GVJ sugjeron</u> që IAL të miratojë edhe kriteret e veçanta për përzgjedhjen si student prej kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren mësimore të programit të studimit janë përcaktuar modalitetet në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Nëpërmjet koordinatores së Departamentit, çdo studenti tëinteresuar i jepet mundësia e tërheqjes së formularin e paradiplomimit, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, si dhe statusi për çdo lëndë.

	<i>Ref. Dokumenti Nr. 7;</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>UET ka miratuar një dokument "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin", ku janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme të studentëve.</p> <p><i>(Ref. Dokumenti Nr. 28)</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Studentët e rinj të regjistruar në UET informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit, rregulloret dhe procedurat administrative të UET, gjatë Javës së Orientimit.</p> <p>Studentëve u vihet në dispozicion sylabusi për çdo lëndë e programit të studimit, pjesë e të cilit është edhe mënyra e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Në rregulloren e UET është përcaktuar se studentët këtij programi studimi, mund të diplomohen nëpërmjet temës së diplomës. <i>(Ref. Dokumenti Nr. 5)</i></p> <p>IAL ka përcaktuar të gjithë procedurën, si dhe kriteret formale të punimit të temës së diplomës, në një dokument të veçantë. <i>(Ref. Dokumenti Nr. 10).</i></p> <p>Për çdo vit akademik, institucioni ka hartuar "Kalendarin akademik", të cilat i bëhen të ditura studentëve në fillim të çdo viti akademik dhe kanë të përcaktuara fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>(Ref. Dokumenti Nr. 10.1; Nr. 10.2; Nr. 10.3; Nr. 10.4).</i></p>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Informimi i kandidatëve të interesuar mbi programin e studimit, realizohet nëpërmjet aktiviteteve si "Panairt e Punës", apo "Open Days". Përpos informimit, kandidatëve të interesuar u është krijuar mundësia për të vizituar nga afër ambientet e institucionit.</p>
Konkluzione	<i>UET vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë në</i>

	<i>lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, njohjes së kualifikimeve të mëparshme, vlerësimit të dijeve dhe procedurat e punimit të diplomës. UET organizon gjithashtu takime të hapura për informimin e studentëve për sa më sipër.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Rezulton se ka disa mënyra, nëpërmjet të cilave studentët informohen mbi elementët e programit të studimit, që janë: Informacioni në momentin që kandidatët interesohen për programin e studimit; Kontrata që nënshkruhet midis IAL-së dhe studentit në momentin e regjistrimit; Rregullorja mësimore e programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në momentin e regjistrimit studentët informohen mbi programin e studimit, i detajuar me lëndët dhe modulet që përban, informacion i cili gjendet edhe në faqen e internetit të UET. Gjithashtu studentët informohen edhe me programe të gjitha lëndëve që do të zhvillohen, ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Informacioni i mësipërm aksesohet edhe nëpërmjet LMS. (Ref. Dokumenti Nr. 7).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Informimi i studentëve për punësim bëhet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, e cila dërgon njoftime tek studentët mbi mundësitë e ndryshme për punësim. (Ref. Dokumenti Nr. 12). Në IAL funksionon dhe një strukturë e veçantë që është "Bordi i

	tregut të punës”. (Ref. Dokumenti Nr. 12.1) IAL ka marrë pjesë gjithashtu nëpunairët e punës dhe aktivitete me aktorë nga tregu i punës. (Ref. dokumenti Nr. 12.2)			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informimi i studentëve për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor realizohet nëpërmjet koordinatores së departamentit.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Çdo informacion në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, u dërgohet studentëve përmes postës elektronike dhe sistemit LMS. Studentët pajisen të gjithë me një adresë e-maili të UET.			
Konkluzione	<i>UET vë në dispozicion të studentëve një informacion të plotë, në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, lëndët dhe modulet e programit, ngarkesa dhe temat për çdo javë mësimore. Ky informacion është në dispozicion të studentëve edhe nëpërmjet një sistemi të informatizuar. Studentët e programit, në proces akreditimi, informohen mbi mundësitë e ndryshme për punësim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni i

Për programin e studimit “MSH” në e drejtë private dhe


<p>arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>biznesi”, konstatohet mbajtja e statistikave të lidhura me studentët dhe punësimin e tyre pas diplomimit (gjurmueshmëria e studentit). Të dhënat janë paraqitura të detajuara me numra dhe përqindje. (Ref. Dokumenti Nr. 27); (Ref. Dokumenti Nr. 29).</p>																																									
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Për programin e studimit, në proces vlerësimi, disponohen statistika për regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, dhe kalueshmërinë.</p> <p>Mbështetur në Evidencën nr. 27 “Cilesia ne hyrje_dalje_MSH E drejte private dhe biznesi” rezulton se numri i studentëve të regjistruar në katër vite akademike për këtë program është:</p> <table border="1" data-bbox="587 768 1402 1193"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Programi/profili</th> <th>Te regjistruar për herë të parë</th> <th>Të transferuar</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="2">19-20</td> <td>E drejtë Biznesi</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>E Drejtë Private</td> <td>41</td> <td>0</td> <td>41</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">20-21</td> <td>E drejtë Biznesi</td> <td>15</td> <td>5</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>E Drejtë Private</td> <td>31</td> <td>1</td> <td>32</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">21-22</td> <td>E drejtë Biznesi</td> <td>7</td> <td>3</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>E Drejtë Private</td> <td>21</td> <td>0</td> <td>21</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">22-23</td> <td>E drejtë Biznesi</td> <td>6</td> <td>0</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>E Drejtë Private</td> <td>19</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Programi/profili	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali	19-20	E drejtë Biznesi	8	1	9	E Drejtë Private	41	0	41	20-21	E drejtë Biznesi	15	5	20	E Drejtë Private	31	1	32	21-22	E drejtë Biznesi	7	3	10	E Drejtë Private	21	0	21	22-23	E drejtë Biznesi	6	0	6	E Drejtë Private	19	1	20
Viti akademik	Programi/profili	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali																																						
19-20	E drejtë Biznesi	8	1	9																																						
	E Drejtë Private	41	0	41																																						
20-21	E drejtë Biznesi	15	5	20																																						
	E Drejtë Private	31	1	32																																						
21-22	E drejtë Biznesi	7	3	10																																						
	E Drejtë Private	21	0	21																																						
22-23	E drejtë Biznesi	6	0	6																																						
	E Drejtë Private	19	1	20																																						
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>IAL ka në administrim një sistem të brendshëm të informacionit (“Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Universitetit” - UMIS) nëpërmjet të cilit realizohet ruajtja, administrimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore të studentëve.</p>																																									
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe</p>	<p>Informacioni mbi studentët dhe dokumentacioni përkatës kontrollohet periodikisht pranë sekretarisë mësimore, për të verifikuar saktësinë e tij.</p> <p>(Ref. vizita në IAL)</p>																																									

saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.									
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti i Shkencave Juridike mban të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Ref. Dokumenti Nr. 29). Departamenti harton raporte periodike me të dhëna në lidhje me profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje (Ref. Dokumenti Nr. 27). Këto të dhëna përdoren si analiza të departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese (Ref. Dokumenti Nr. 38).								
Konkluzione	<i>Për programin e studimit në proces vlerësimi, disponohen statistika të plota lidhura me cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, ç'regjistrimin e tyre punësimin etj. Këto të dhënat ruhen dhe përpunohen nëpërmjet "Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Universitetit". Departamenti i Shkencave Juridike harton raporte me të dhëna në lidhje me cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, me të dhëna të diplomimit dhe të punësimit të studentëve, në mënyrë që të analizohet arritja e objektivave të programit të studimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e	Aktet rregullatore të IAL-së parashikojnë përfaqësimin e studentëve në organet vendimmarrëse. (Ref. Dokumenti Nr. 2, nenet 16, 19 dhe 51). Studentët marrin pjesë: Këshillin e Studentëve; Senatin Akademik; Këshillin e Etikës; KSBC;



këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Konstatohet se studentët përfshihen realisht në proceset e vlerësimit të veprimtarisë akademike. Psh. një student përfshihet në monitorimin e provimeve pjesore apo përfundimtare të lëndëve (Shiko “Relacionin mbi kontrollin e provimeve përfundimtare, zhvilluar në semestrin e I-rë, viti akademik 2021 – 2022”) (Ref. Dokumenti Nr. 30.8). Po kështu studentët kanë qenë pjesë e fokus grupeve dhe kanë marrë pjesë në hartimin e Raportimit të Fokus Grupeve (Ref. Dokumenti Nr. 30.13; Nr. 30.14).
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Perceptimi i studentëve për mësimdhënien, lëndët e programit dhe literaturën merret nëpërmjet zhvillimit të fokus grupeve dhe pyetësorëve online. Studentët pyeten në lidhje me rritjen e cilësisë së shërbimeve që ofron IAL për studentët dhe rritjen e cilësisë në programin e studimit. (Ref. Dokumenti Nr. 30.14 dhe Nr. 30.15). Mbledhja e perceptimeve të studentëve bëhet nëpërmjet metodës së pyetësorëve, apo mbledhjes së ankesave drejtpëdrejtë. (Ref. Dokumenti Nr. 40, Nr. 40.1 dhe Nr. 40.2).
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve është një element ku studentët japin opinionin e tyre. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë vlerësimin e tyre, duke shprehur mendimin mbi lëndën (dobishmëria e saj, niveli i vështirësisë, përmbushja e pritshmërive) dhe mbi lektorin e lëndës (kuptueshmëria e shpjegimit, metodologjia, etj.). Studentët këtë mendim e japim gjatë vlerësimit on line. (Ref. Dokumenti Nr. 40.1)
Konkluzione	Studentët e këtij programi studimi marrin pjesë në strukturat drejtuese të institucionit. Opinion i studentëve mbi elementët e programit të studimit, si lëndët, literatura, mësimdhënia dhe vlerësimi i dijeve, merret nëpërmjet zhvillimit të fokus grupeve,




	<i>pyetësorëve online dhe mbledhjeve të hapura të departamenteve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në IAL është ngritur një strukturë e veçantë që është “Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit”. Zyra e Kujdesit ndaj Studentit kujdeset veçanërisht për qeverisjen dhe aktivitetet e studentëve; Eventet special; Klubet dhe organizimet e studentëve; Qeverinë studentore; Shkollat stinore për studentët; Trajnimet online të studentëve për çështje të ndryshme, etj. Zyra e Këshillimit të Karrierës e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Kjo strukturë organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së IAL-së. (Ref. Dokumenti Nr. 12).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Tutoriati dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik. Në lidhje me tutariatin, çdo anëtar i personelit të brendshëm akademik ka në ngarkim një grup studentësh dhe qëndron 1 (një) orë në javë në një sallë të caktuar, në funksion të këtij shërbimi. Në lidhje me këshillimin akademik, çdo pedagog është i detyruar të qëndrojë në zyrën e caktuar 1 (një) orë në javë, jashtë orarit të mësimit, në dispozicion të studentëve që ndjekin lëndën e tij. (Ref. Dokumenti Nr. 27.2).
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar	Shërbimi i këshillimit të karrierës realizohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, e cila organizohet me persona, të cilët kanë orare të shpallura të pritjes së studentëve. Kjo zyrë ka si detyrë funksionale: Këshillimin e vazhdueshëm për studentët, duke i mbështetur në hartimin e CV, letrës së motivimit, për fazat e intervistës së punës; Përgatit kalendarin e eventeve, si “Open Day” për çdo fakultet dhe

informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	panairët e punës; Zhvillon sondazhin e planit të karrierës së studentëve, etj. (Ref. Dokumenti Nr. 12).			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar, mbledh informacion dhe përpunon statistika mbi Alumnin, sa integrohen në tregun e punës, sa vazhdojnë studimet, etj; Gjithashtu kjo zyrë ndërton database me burime të mundësive të ndryshme për punësim, internship, bursa studimi, etj, duke i shpërndarë njoftimet tek studentët për të cilët mund të kenë interes. (Ref. Dokumenti Nr.29).			
Konkluzione	<i>Informimi dhe këshillimi i studentëve të programit të studimit realizohet nga "Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit". Kjo e fundit ndjek studentët nga regjistrimi deri në diplomim, madje merr informacion edhe për punësimin e tyre. Gjithashtu IAL organizon tutoriatin dhe këshillimin akademik të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

69

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UET ka hartuar dokumenta për sigurimin e brendshëm të cilësisë, që janë Strategjia për Sigurimin e Cilësisë dhe Manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Fusha të vlerësimit të brendshëm në kuadër të sigurimit të cilësisë janë edhe programet e studimit dhe mësimdhënia (<i>Ref. Dokumenti Nr.30.2 dhe Nr.30.3</i>).</p> <p>Sipas këtyre dokumentave, cilësia e programeve dhe e mësimdhënies sigurohet nëpërmjet: përcaktimit të kriterëve të hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, zbatimit të sistemit të krediteve, vlerësimit dhe përmirësimit të syllabuseve, vlerësimit të mësimdhënies, rregullores së studimeve, cilësisë dhe personelit të kërkuar për mbulimin e ngarkesës të veprimtarive mësimore të programit, politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare, përdorimit të teknologjive bashkëkohore në mësimdhënie, sigurimit të fondit të teksteve sipas fushave të studimit në bibliotekë dhe aksesit në librari elektronike.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Vlerësimi i procesit të mësimdhënies bëhet nëpërmjet pyetësorit on line, nëpërmjet sistemit LMS. Cilësia e mësimdhënies dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve analizohen dhe nga fokus grupet, por gjithashtu analizohen dhe nga departamentit përgjegjës në analizat që ai zhvillon mbi arritjen e objektivave të programit të studimit MSH.Dr.P.B.</p> <p>(<i>Ref. Dokumenti Nr.30.15, Dokumenti Nr.38 dhe Nr.40.1</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>IAL ka garantuar përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik, të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. Kjo është realizuar nëpërmjet pyetësorit on line të studentëve, duke ruajtur anonimatit e tyre, ku studentët japin perceptimin e tyre mbi zhvillimin e lëndës, dobishmërinë e saj, si dhe mbi lektorin. Gjithashtu studentët japin vlerësim edhe si pjesë e fokus grupeve (<i>Ref. Dokumenti Nr.30.15, Nr.40 dhe Nr.40.1</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, kanë përgjegjësinë</p>

përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	për komunikimin dhe publikimin e rezultateve të monitorimit, dhe vlerësimit, në përputhje me format e miratuara nga Rektorati dhe Senati Akademik. Ky proces mbikqyret nga KSBC në nivel Institucioni dhe informacioni përditësohet rregullisht. Komunikimi dhe publikimi kryhen në disa mënyra: Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse; RVB dhe RVJ publikohen në faqen zyrtare të IAL; Vlerësimi i programeve të studimit, vlerësimi i lëndës dhe rishikimet përkatëse publikohen në rrjetin e brendshëm elektronik të shkëmbimit të informacionit; Raportet e vlerësimeve individuale, u komunikohen në mënyrë konfidenciale personelit. (Ref. Dokumenti Nr.30.3)			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Rezultatet dhe të dhënat e grumbulluara nga proceset e monitorimeve dhe vlerësimeve të kryera në IAL, në kuadër të sigurimit të cilësisë, përdoren për disa qëllime si: Përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm; Përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve dhe mësimdhënies; Planifikimin vjetor të veprimtarive në UET; Përmirësimin e performancës së personelit. (Ref. Dokumenti Nr.30.3).			
Konkluzione	UET ka një politikë të qartë dhe ka ngritur mekanizma për kontrollin e cilësisë së mësimdhënies. Këto mekanizma përfshihet edhe mendimi i studentëve. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së raportohen periodikisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të

UET ka të përcaktuar në Statutin dhe Rregulloren e UET, si dhe në Strategjinë “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë” dispozita që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë të programit të studimit.

<p>Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>-Në statut, neni 11 dhe 16; -Në Rregulloren e UET, neni 6, par.6.1, pika 2; -Strategjia për sigurimin e cilësisë 2023 – 2028, miratuar me Vendim Senati Nr. 15, datë 23/12/2022; -Dokumenti F.VII. “Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë”; <i>(Ref. Dokumenti Nr. 2, Nr. 5; Nr. 30.3 dhe Nr. 8).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në IAL është ngritur një Sistem i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në zbatim të Statutit të IAL-së, neni 16 dhe Rregullores së UET, neni 6, pika 2. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore në IAL. <i>(Ref. Dokumenti Nr. 30, Dokumenti Nr. 30.4);</i> Aktualisht Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas Vendimit të Senatit Akademik nr.5, datë 30.03.2023, përbëhet nga 12 anëtarë dhe ka në përbërje dhe një student. IAL ka miratuar një Strategji për Sigurimin e Cilësisë, 2023 – 2028, me vendim të Senatit Akademik Nr.15, datë 23.12.2022.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC) në IAL ka si detyrë të zhvillojë politikat, strategjitë, proceset dhe udhëzimet, në funksion të rritjes së cilësisë në UET, si edhe të monitorojë zbatueshmërinë korrekte të tyre nga njësitë akademike dhe administrative. Kjo zyrë mbledh të dhënat nga njësitë përkatëse të institucionit, zhvillon pyetsorë ose focus grup-e me studentët, harton raportet me gjetjet përkatëse, etj. <i>(Ref. Dokumentet Nr. 8)</i> Institucioni i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme. <i>(Ref. Dokumentet Nr. 54.3 – 54.6).</i> Edhe programi i studimit MSH.Dr.P.B i është nënshtruar procesit të akreditimit <i>(Vendimi i BA Nr.22, datë 11.05.2018).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni përdor standartet kombëtare të cilësisë si tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, si dhe ato të parashikuara nga organizma ndërkombëtare (ENQA), të cilat i ka parcaktuar në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë <i>(Ref. Dokumenti Nr.30.2).</i></p>

Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.									
Konkluzione	<i>UET ndjek politikë të qartë dhe zbaton mekanizma transparent për sigurimin e cilësisë së veprimtarisë së institucionit dhe realizimin e programit të studimit. Institucioni përdor standartet kombëtare të cilësisë si tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura</p>	<p>Mekanizmat e përdorur, në kuadër të vlerësimit të cilësisë, për monitorimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, vlerësimit të syllabuseve, apo vlerësimit të provimeve, kanë prodhuar raporte periodike. Këto raporte/relacione i bëhen me dije strukturave dhe autoriteteve drejtuese përkatëse (<i>Ref. Dokumenti Nr.30.8, 30.12 dhe 30.15</i>).</p> <p>Struktura drejtuese e programit të studimit në proces vlerësimi (Departamenti i Shkencave Juridike) analizon periodikisht arritjen e objektivave të programit të studimit (<i>Ref. Dokumenti Nr.38</i>).</p>

<p>autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit kanë të evidentur përputhshmërinë e aktiviteteve të programit të studimit me parashikimet në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH” dhe VKM Nr. 531, date 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë” lidhur me standardet e cilësisë. Psh. monitorohet i syllabueseve të lëndëve të programit dhe evidentohet në racion problematikat e evidentuara (Ref. Dokumenti Nr.31.12).</p> <p>KSBC dhe strukturat e përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë kanë kryer monitorimin e procesit të marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Metodat e drejtpërdrejta të përdorura si mekanizma për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i provimeve; - Vlerësimi i programeve të lëndëve; - Matrica e përputhshmërisë së syllabuseve; - Vlerësimi i pedagogëve nga eprori dhe kolegu; - Analizë mbi arritjen e objektivave formuese; <p>(Ref. Dokumenti Nr.30.6, Nr.30.10, Nr.30.16, Nr.37 dhe Nr.38).</p> <p>Për stafin akademik përdoret metoda e vlerësimit të performacës me vetvlerësim nëpërmjet “Formularit të vetvlerësimit të performancës së personelit akademik” (Ref. Dokumenti Nr.41).</p> <p>Me Vendimin e Senatit Akademik Nr.2, datë 04.05.2020 “Mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19”, në kushtet e vijimit të procesit akademik online përmes platformave UET LMS dhe Microsoft Teams, procesi i monitorimit të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve është mundur nga Zyra e IT në UET. Dokumentimi është bërë nëpërmjet raporteve të vazhdueshme mbi aksesimin e platformave nga stafi akademik/studentët, prezenca në mësim, kohëzgjatja e orëve mësimore, etj. (Ref. Dokumenti Nr. 5.1; Nr.</p>

	46.5; Nr. 46.6). Monitorimi i cilësisë, metodologjisë së mësimdhënies dhe orëve mësimore kryhet nga Përgjegjësi i Departamentit.			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Metodat e tërthorta të përdorura si mekanizma për vlerësimin e cilësisë, janë kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për marrjen e opinionit të tyre në lidhje me lëndën si dhe në lidhje me pedagogun (Ref. Dokumenti Nr. 40 dhe Nr. 40.1). Gjithashtu janë përdorur dhe formularët për adresimin e kërkesave të studentëve, në lidhje me programin e studimit në tërësi (Ref. Dokumenti Nr.40.2).			
Konkluzione	<i>Institucioni harton raporte të vlerësimeve periodike për mbikqyrjen dhe vlerësimin e programit të studimit, ku evidentohet përputhshmëria e programit të studimit me parashikimet e kuadrit normativ në fuqi. Në këto vlerësime merret dhe opinionin e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve


<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në përbërjen e KSCB, aktualisht është përfshirë edhe një ekspert i jashtëm, prezenca e të cilit është parashikuar edhe në statutin e IAL-së, neni 16.2 (Ref. Dokumenti Nr.2 dhe Nr.30.4).</p> <p>Një kontribut në përmirësimin e instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve, në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë, ka dhënë dhe pjesëmarrja e IAL-së, si partner në dy projektet ndërkombëtare: “ENCHASE” (në kuadër të projekteve TEMPUS) dhe “QainAL” (në kuadër të projekteve Erasmus+). Të dy këto projekte ndërkombëtare kanë pasur si objekt rritjen e nivelit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. (Ref. dokumenti Nr. 30.19 dhe Nr. 30.20).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në aktet e brendshme rregullatore, strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë përcaktuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organet dhe autoritetet drejtuese të UET-it; - Zyra e Standardeve dhe Cilësisë; - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC; <p>Mënyra se si krijohen, përberja dhe detyrat e këtyre strukturave, në funksion të përmirësimit të cilësisë, janë të përcaktuara në aktet rregullatore të brendshme të institucionit.</p> <p>(Ref. Dokumenti Nr. 8)</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademiq e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Statuti i IAL-së, në nenet 11 dhe 16, si dhe “Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2023 – 2028” (pika 3.1) parashikon detyrime konkrete institucionale për departamentin, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademiq e administrativ, si dhe për studentët, në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p> <p>(Ref. Dokumenti Nr.2 dhe Nr.30.3)</p> <p>Në raportet e hartuara nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kanë marrë pjesë pedagogë, një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademiq, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të</p>	<p>Referuar në dokumentin “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”, GVJ vlerëson se, të paktën formalisht, përzgjedhja e anëtarëve të KSBC bëhet duke respektuar integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi kundrejt personelit dhe studentëve.</p>

respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<i>(Ref. Dokumenti Nr. 8, pika 7.3)</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	IAL ka angazhuar një ekspert të jashtëm në strukturën e KSBC-së. Gjithashtu, ekspertizë të jashtme në rritjen e cilësisë së programit të studimit jep dhe Bordi i Tregut të Punës. <i>(Ref. Dokumenti Nr. 30.4 dhe Nr. 12.1)</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, në proceset e sigurimit dhe përmirësimin të vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në këto procese angazhohen staf akademik të njësisë bazë, staf administrativ dhe studentë. Kontribut në vlerësimin e brendshëm të cilësisë ka dhënë edhe marrja e eksperiencës në projektet ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për	Planifikimi i Veprimtarisë së KSBC-ja bëhet sipas një kalendari të përvitshëm (Plan i veprimit KSBC), në të cilin programohen të gjitha aktivitetet vlerësuese. <i>(Ref. Dokumenti Nr. 30.1)</i> IAL ka miratuar dhe ka bërë publike “Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë 2023 – 2028”, të miratuar me Vendim Senati Nr. 15, datë




programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	23.12.2022, si dhe “Manualin për sigurimin e brendshëm të cilësisë” (Ref. Dokumenti Nr. 30.2 dhe Nr. 30.3)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të IAL-së. Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të KSBC u komunikohen në mënyrë të përmbledhur autoriteteve drejtuese të Institucionit, si dhe raportet e veçanta u komunikohen drejtuesit të njësisë bazë. Raportet e vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe të jashtëm (RVJ) dhe vendimet e akreditimit publikohen në faqen zyrtare të internetit. Raportet e vlerësimeve individuale, u komunikohen në mënyrë konfidenciale personelit.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e proceseve të monitorimit dhe vlerësimit shoqërohen nga një proces ndjekje të adresimit të gjetjeve (procesi folloë-up). Të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, janë përdorur nga drejtuesit e institucionit për të bërë vlerësimin e performances akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik. (Ref. dokumenti Nr. 41)
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Rezultatet dhe të dhënat e grumbulluara nga proceset e monitorimeve dhe vlerësimeve të kryera, përdoren për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve, planifikimin vjetor të veprimtarive në IAL, si dhe përmirësimin e performancës së personelit. (Ref. dokumenti Nr.30.3)
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Referuar Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë së IAL-së, rezulton se strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe publikimin e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Por, nuk parashikohen dhe nga GVJ nuk u konstatua planifikimi apo kryerja e takimeve (mbledhjeve) periodike me personelin dhe studentët, për të diskutuar me ta mbi sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. <i>Nga GVJ sugjerohet kryerja e këtyre veprimtarive.</i>
Konkluzione	<i>Raportimet për veprimtaritë, në kuadër të sistemit të Sigurimit të</i>

	<p><i>Brendshëm të Cilësisë, bëhen transparente. Ato shërbejnë kryesisht për të bërë vlerësimin e performancës akademike të stafit.</i></p> <p><i>Nga GVJ sugjerohet planifikimi dhe kryerja e takimeve periodike me personelin dhe studentët për ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile “E Drejtë Private”, “E Drejtë Biznesi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni i arsimit të lartë përdor një sistem bashkohor të menaxhimit të informacionit, LMS (Learning Management System), i cili siguron për personelin akademik dhe studentët e këtij programi njëinformim dhe komunikim cilësor e transparent, si dhe ndihmon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies;
2. Institucioni dhe njësia bazë (Departamenti i Shkencave Juridike) mbledh dhe shfrytëzon, nëpërmjet pyetësorëve on line, opinionin e studentëve për të përmirësuar aspekte të veçanta të programit të studimit;
3. Institucioni i arsimit të lartë (UET) ka lidhur marrëveshjeve të shumta bashkëpunimi me universitete vendase dhe të huaja, biznese, organizata, institucione publike etj., të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave dhe/apo punësim të studentëve;
4. Institucioni është në administrim të një infrastrukture të përshtatshme, me mjedise të mjaftueshme (salla për leksione, seminare, laboratorë, etj.), të pajisura konform standardeve bashkëkohore, me mjetet dhe paisjet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor për programin e studimit në proces vlerësimi;

b. Pika të dobëta:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

79

1. Ndryshimi ligjor i strukturës së programit të studimit “Drejtësi”, nga Bachelor + Master (3+2 vite) në program të integruar “Master i shkencave” (5 vite), bart rrezikun e pakësimit të numrit të studentëve të interesuar për të ndjekur programin 2-vjeçar “Master i Shkencave” në “E Drejtë Private dhe Biznesi”; (*Standarti V.4, Kriteri 2 - numri i studentëve të regjistruar në 4 vite akademike vjen në rënie*)
2. Pavarësisht se situata është përmirësuar nga vlerësimi i mëparshëm, institucioni ende vazhdon të angazhojë në mësimdhënie, në këtë program studimi, staf akademik që nuk e ka të paktën gradën shkencore “Doktor i shkencave”, duke mos plotësuar kushtin ligjor për të patur së paku kualifikimin e ciklit pasardhës; (*Standarti IV.1, Kriteri 1*)

Rekomandime:

1. Çdo Fakultet të ketë rregullore të dedikuara për mbarëvajtjen dhe mbështetjen e veprimtarisë, konform ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ku të parashikohen, në mënyrë të detajuar, të gjitha modalitetet e drejtimit, koordinimit, detyrat/rolet përgjegjësitë për secilin autoritet;
2. Të zhvillohen vizita në gjykata të ndryshme, për të parë nga afër si zhvillohet një proces gjyqësor civil, ose edhe me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit apo studio që ofrojnë konsulencë në fushën e arbitrazhit tregtar;
3. IAL të ketë më tepër fokus në grantet e financimit të kërkimeve të thelluara të personelit akademik dhe të studentëve, për çështje që vlerësohen prioritare në fushën e së drejtës private dhe të biznesit;
4. Për realizimin e programit të studimit, IAL të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik;
5. IAL të miratojë edhe kritere të veçanta për përzgjedhjen si student të kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara;
6. Të planifikohen dhe të kryhen takime periodike me personelin dhe studentët për ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit;



Evaluation's conclusions for the second cycle study program "Master of Science" on "Private and Business Law", with profiles "Private Law", "Business Law"

a. Strengths and Affirmations:


1. The higher education institution uses a simultaneous information management system, LMS (Learning Management System), which provides the academic staff and students of this program with qualitative and transparent information and communication, as well as helps to improve the quality of teaching;
2. The institution and the basic unit (Department of Legal Sciences) collect and use, through online questionnaires, the opinion of students to improve specific aspects of the study program;
3. The higher education institution (EUT) has concluded numerous cooperation agreements with local and foreign universities, businesses, organizations, public institutions, etc., which enable the development of internships and/or employment of students;
4. The institution manages a suitable infrastructure, with sufficient facilities (lecture rooms, seminars, laboratories, etc.), equipped according to contemporary standards, with the necessary tools and equipment for the development of the learning process for the study program in evaluation process;

b. Weaknesses:

1. The legal change of the structure of the "Law study program", from Bachelor + Master (3 +2 years) to the integrated program "Master of Science" (5 years), carries the risk of reducing the number of students interested in following the 2-year "Master of Science" program in "Private and Business Law"; *(Standard V.4, Criterion 2 - the number of students enrolled in 4 academic years is decreasing)*
2. Despite the fact that the situation has improved since the previous evaluation, the institution still continues to engage in teaching, in this study program, academic staff who is not entitled at least with the "Doctor of Sciences" scientific degree, not fulfilling the legal condition to have at least the qualification of the next cycle; *(Standard IV.1, Criterion 1)*

Recommendation:

1. Each Faculty should have Regulations dedicated to the running and support of their activity, in accordance with Law No. 80/2015 "On higher education and scientific research in institutions of higher education in the Republic of Albania", where all modalities of direction, coordination, tasks/roles, responsibilities for each authority are to be provided accordingly;



2. Conducting visits to different courts, to see closely how a civil court process takes place, or even with the National Chamber of Mediation or studios that offer consultancy in the field of commercial arbitration;
3. HEI should have more focus on funding grants for in-depth research of academic staff and students, for issues that are considered priority in the field of private and business law;
4. For the realization of the study program, the HEI should engage in teaching only academic personnel entitled with at least the PhD degree, in accordance with the legal requirements for the appropriate level of academic qualification;
5. The HEI should adopt special criteria for the selection as students of candidates with special needs, minorities and marginalized groups;
6. To plan and carry out periodic meetings with the staff and students for their awareness of ensuring and improving the quality of the study program;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X